

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5441
E martë, 3 prill 2018
çmimi 0.40 €

Shoqatat e luftës kërkojnë që shtatorja e Adem Jasharit të vendoset në Prishtinë | **FAQE 6**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

FINALJA E DIALOGUT KOSOVË - SERBI

F. 6

Shkëlzen MALIQI



TESTI I MATURËS, PYETJET NUK DO TË JENË TË NJËJTA NË TËRË KOSOVËN F. 6

GJYKATA E APELIT KA ZGJIDHUR 145 LËNDË PËR KORRUPSION F. 3

EKONOMI

TARIFA QË GODET EKONOMINË F. 9

RUSINOVCË: BUJQËSIA NË KOSOVË PO KARAKTERIZOHET ME RËNIE TË PRODHIMIT F. 8

KULTURË

ALEKSANDËR MOISIU, GJENIU I ARTIT SKENIK BOTËROR F. 13

Prof. dr. Isak SHEMA

SPORT

MORINA: FERONIKELI NUK HEQ DORË NGA TITULLI F. 18

SHQIPËRIA, MIQËSORE ME KOSOVËN MË 29 MAJ F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", NASER RUGOVA | **FAQE 4-5**

LDK-ja s'do të jetë pjesë e kësaj qeverie të papërgjegjshme

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Naser Rugova, ka kritikuar koalicionin qeverisës, duke thënë se Kosova prej se është çliruar nuk ka pasur qeveri më të dobët dhe më të papërgjegjshme. Ai ka vlerësuar se nën

drejtimin e këtij koalicioni qeverisës Kosova ka ngecur në të gjitha aspektet. Rugova ka hedhur poshtë mundësinë që LDK-ja të bëhet pjesë e Qeverisë Haradinaj pas largimit të Listës Serbe. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka

e re", Rugova ka bërë me dije se do t'i ndërmarrin masat e nevojshme që sa më shpejt kjo qeveri të shkojë në shtëpi. Sipas Rugovës, LDK-ja më tepër se kurrë është e përgatitur për t'i filluar bisedimet për caktimin e datës së zgjedhjeve të reja

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ I ËSHTË KUNDËR-PËRGJIGJUR PRESIDENTIT TURK REXHEP TAJIP ERDOGAN

Haradinaj: Askush nuk mund të përzihet në punët e brendshme të Kosovës

 | **FAQE 5**

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, më në fund ka dhënë përgjigje për akuzat e Erdoganit, i cili ka thënë se Haradinaj duhet të japë llogari

për shkarkimin e ministrit të Brendshëm dhe të drejtorit të AKI-së. Në një organizim me rastin e vitit të Skënderbeut, Haradinaj ka thënë se



asnjëherë nuk është përzierë në punët e Turqisë. Sipas tij, është traditë ndër shqiptarë që askush të mos ndërhyjë në punët e tjetrit



Qeveria e përkushtuar që ushtria të formohet këtë vit

Përfaqësuesit e institucioneve të vendit presin që këtë vit të këtë vendimarrje për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Forca të Armatosura. Zëvendësiministri i FSK-së, Burim

Ramadani dhe kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, kanë bërë me dije se institucionet janë të përkushtuara që ky proces të përmbyllet në rrugë kushtetuese dhe me mbështetjen e plotë të partnerëve mbështetës | **FAQE 3**

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çarëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GRUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Serweri: Reagimi i Erdoganit pas deportimeve, në vazhden e prirjeve të tij autokrate

Analisti Daniel Serwer ka bërë me dije se reagimi i presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan, pas deportimit të shtetasve turq nga Kosova, është shqetësues, por është në vazhden e prirjeve të tij brenda vendit dhe jashtë tij



WASHINGTON, 2 PRILL - Analisti Daniel Serwer, studiues në Qendrën për Marrëdhënie Transatlantike në Universitetin Johns Hopkins, tha të hënën se reagimi i presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan, pas deportimit të shtetasve turq nga Kosova, është shqetësues, por është në vazhden e prirjeve të tij brenda vendit dhe jashtë tij. Serweri ka thënë se lidhur me rrethanat e deportimit do të ishte mirë të priteshin rezultatet e hetimit.

Analisti Serwer ka shtuar se Erdogani përbën shqetësim për shumë amerikanë jo vetëm për këtë arsye, por edhe për të tjera, përfshirë një sjellje gjithnjë e më autokrate, që nuk është aspak e përshtatshme për një vend që ka pasur aspirata për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe që ende aspiron të jetë demokraci. "Pra po, është shqetësuese, por të them të vërtetën nga perspektiva amerikane është një çështje me rëndësi relativisht të vogël, krahasuar me shqetësimet e tjera, lidhur me Erdoganin, rojat e sigurisë të të cilit rrahën demonstruesit në Uashington. Ka shumë gjëra që janë të gabuara në mënyrën se si po sillen autoritetet turke", ka deklaruar Serweri.

Serweri ka pohuar se Turqia ka luajtur rol pozitiv në Ballkan, veçanërisht në vitet '90 dhe 2000. "Shqetësimi im është se gjithnjë e më shumë Turqia duket se po ushtron ndikimin e saj

përmes lidhjeve me 'Vëllazërinë Myslimane' dhe kjo më shqetëson. Ishte një kohë kur Turqia donte të kishte marrëdhënie të mira me të gjithë në Ballkan dhe mbi ato baza bëri biznes tregtar. Ajo që shoh tani është një sjellje e ndryshme e Turqisë që më shqetëson", ka deklaruar Serweri për "Zërin e Amerikës".

Duke e analizuar ngjarjen e fundit në kontekstin e masave të Turqisë, pas asaj që Erdogani e ka konsideruar si tentativë për grushtshtet të lëvizjes së Fetullah Gulenit, Serweri tha se masat kundër mbështetësve të tij janë të tepruara. "Nuk jam shumë i sigurt për këta individë në Kosovë, por masat pas tentativës për grushtshtet janë shqetësuese për Uashingtonin dhe për këdo që beson se të drejtat e njeriut janë të rëndësishme", ka thënë ai.

Serweri ka theksuar se Perëndimi duhet t'i ndjekë me vëmendje zhvillimet në Turqi dhe ta kritikojë Erdoganin për shumë aspekte, përfshirë këtë çështje. Ai shton se mungesa e vëmendjes nga Perëndimi është pjesë e arsyes që Erdogan nuk druhet të veprojë me forcë brenda dhe jashtë Turqisë. "Por unë mendoj se kjo sjellje e tij vlerësohet brenda Turqisë, se politika turke e sheh këtë si sfidë ndaj të huajve, si rikthim të madhështisë së Turqisë, si ndëshkim të Gulenit që dikur ishte

shumë popullor në Turqi, por tani përçmohet nga shumë turq, pra mendoj se ka një element të brendshëm, përveç atij të jashtëm", është shprehur Serweri.

Analisti amerikan tha se OSBE-ja, Bashkimi Evropian dhe NATO-ja duhet të jenë të gjitha të shqetësuara për drejtimin që po ndjek vetë Erdogan dhe drejtimin nga po e çon Turqinë. Për sa iu takon deportimeve, Serweri ka pohuar se presidenti Hashim Thaçi e ka bërë të qartë se, sipas tij, ata janë përzënë për shkak të aktiviteteve të paligjshme brenda Kosovës dhe shton se para se të japë një gjykim përfundimtar, ai do të donte ta priste përfundimin e hetimit dhe një raport zyrtar, sidomos në kushtet kur kryeministri Ramush Haradinaj thotë se nuk ishte në dijeni të asaj që po ndodhte. "Nuk do të gjykoj se çfarë bën kryeministri Haradinaj. Sipas tij, ishte veprimi i duhur dhe do të shohim nga hetimi se cilat ishin bazat për këtë veprim. Por nëse e kuptoj siç duhet, të paktën për shërbimin e zbulimit, duhet firma e presidentit", ka deklaruar ai. Presidenti turk e ka sulmuar kryeministrin Ramush Haradinaj për qëndrimin e tij ndaj operacionit të deportimit të gjashtë shtetasve turq dhe shkarkimin e ministrit të Brendshëm, Flamur Sefaj dhe shefin e Agjencisë së Zbulimit, Driton Gashi.

LAJME SHKURT



Basha: Ajo që nisi në Kukës nuk do ndalet

TRANË, 2 PRILL - Lideri i PD-së, Lulzim Basha, ishte i pranishëm në përkujtimin e katër dëshmorëve të demokracisë në qytetin e Shkodrës. Ai deklaroi se heronjtë e 2 prillit janë frymëzim i përhershëm. Në këtë aktivitet nuk munguan akuzat e kryedemokratit në drejtim të kryeministrit Edi Rama. Basha tha se Kukësi e ndali të keqen dhe theksoi se ky është një fillim i mbarë i pranverës. "Në Shqipërinë e Edi Ramës, njësoj si në atë të diktaturës, nuk ka të ardhme dhe emigracioni vijon të shihet si zgjidhje. Një grup njerëzish synojnë të pasurohen për vete, duke vjedhur e grabitur vendin. Ky është muaji ku maska e Edi Ramës ka rënë. Taksa e rrugës, taksa e pronës, fatura e ujit dhe dritave, heqja nga ndihma ekonomike, janë tregues se ai tallet me popullin e tij. I them sot nga Shkodra, se ajo që nisi në Kukës nuk do të ndalet dhe nuk ka për të ndaluar derisa tirania e kimit të rrëzohet. Pesë ditë më parë Rama e sfidoi popullin me fjalorin e tij të ndryrë dhe populli i Kukësit i dha përgjigjen e merituar", deklaroi Basha.



Opozita kërkon përjashtimin e Ramës nga Kuvendi

TRANË, 2 PRILL - Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI), Monika Kryemadhi, e ka quajtur fyerje për shqiptarët deklaratën e kryeministri Edi Rama se nuk kishte pse të negociohej me Kosovën për tarifën në "Rrugën e Kombit". "Edi Rama dhe oborri i tij arrogant, të mbyllur në kullat e oligarkëve, nuk e kuptojnë që sot shqiptarët janë ngritur kundër regjimit skllavërues që ai po instalon. Fjala e tij para shqiptarëve ishte jo vetëm një fyerje që u bëhet banorëve të Kukësit, por edhe një shprehje e qartë e antikombëtarizmit të tij që i trajton kosovarët si klientë të pazareve të oligarkëve të tij", ka deklaruar Kryemadhi. Ajo në një konferencë me gazetarë ka thënë se opozita distancohet nga ky vendim i kryeministrit Rama.

Madje Kryemadhi ka bërë me dije se opozita e bashkuar do ta dorëzojë në Kuvend kërkesën për përjashtimin e kryeministrit Rama nga ky institucion. "Sot distancohemi dhe dënojmë me forcë deklaratën e tij, fjalorin e tij vulgar prej rrugaçi dhe përçmimin për shqiptarët e Kosovës, ndaj do të kërkojmë përjashtimin e kryeministrit nga Parlamenti për këto shfaqje të shëmtuara. Qëndrimi ynë do të jetë vendimtarë në funksion të mënyrës së sjelljes së këtij kryeministri", ka thënë Kryemadhi.

Formimi i ushtrisë mbetet objektiv i Qeverisë së Kosovës

Qeveria e përkushtuar që ushtria të formohet këtë vit



Përfaqësuesit e institucioneve të vendit presin që këtë vit të këtë vendimarrje për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Forca të Armatosura. Zëvendësministri i FSK-së, Burim Ramadani dhe kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, kanë bërë me dije se institucionet janë të përkushtuara që ky proces të përmbyllet në rrugë kushtetuese dhe me mbështetjen e plotë të partnerëve mbështetës. Sipas tyre, formimi i ushtrisë nuk duhet të shihet si një proces në të cilin vetoja mund të përdoret përgjithnjë

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 2 PRILL - Institucionet e Kosovës janë të përkushtuara që transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Forca të Armatosura të ndodhë këtë vit. Zyrtarët e lartë shtetërorë kanë bërë me dije se nuk do ta presin deri në pafundësi veton për këtë çështje. Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Burim Ramadani, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ky proces është i pakthyeshëm. "Angazhimi ynë institucional është i koordinuar mirë dhe gjithëpërfshirës, me qëllim që procesi të përmbyllet në rrugë kushtetuese e ligjore dhe ta ketë mbështetjen e plotë të partnerëve mbështetës. Nuk

mund të flas për kushtëzime as përmbajtjesore dhe as kohore. Procesi i transformimit nuk është dhe nuk duhet të shihet si një proces në të cilin vetoja mund të përdoret përgjithnjë. Transformimi në FAK është proces i pakthyeshëm. Për më shumë, kjo do ta bëjë më të sigurt Kosovën dhe do të kontribuojë në sigurinë rajonale", ka thënë Ramadani. Ai ka deklaruar se ky proces është një ndër objektivat kryesore të Qeverisë. "Transformimi i FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës (FAK) është objektiv i Qeverisë së Kosovës dhe objektiv nacional për të cilin ka angazhim të plotë në baza ditore të punës. Kryeministri Haradinaj, Qeveria e Kosovës dhe Ministria e FSK-së janë të përkushtuar për përmbyll-

jen me sukses të plotë të këtij procesi, si një prej hapave më të rëndësishëm në sigurinë e Kosovës dhe kontributin për sigurinë rajonale e më gjerë", ka thënë zëvendësministri Ramadani.

Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh kryetar i PDK-së, Kadri Veseli, ka shprehur optimizëm se deri në fund të vitit do të kenë edhe vendimarrje të përfunduar për krijimin e ushtrisë së Kosovës. "Besoj se fundi i këtij viti do të na gjejë me liberalizim të vizave për qytetarët tanë. Fundi i këtij viti do të na gjejë në një proces shumë më përpara drejt vendit kandidat në BE. Fundi i këtij viti do të na gjejë me një vendimarrje ndoshta edhe të përfunduar për ushtrinë e Kosovës. Fundi i këtij viti do të na

gjejë me hapat që janë marrë në reformat ekonomike dhe juridike që vendi ynë, qytetarët tanë, të gjejnë perspektiva për të jetuar e jo të gjejnë alternativa në vendet e huaja", ka deklaruar Veseli për "Kosovapress".

Ndërsa njohësit e çështjeve të sigurisë kanë bërë me dije se institucionet e Kosovës deri te formimi i ushtrisë duhet të investojnë në forcimin e institucioneve të tjera të sigurisë. "Për sa kohë që kemi NATO-n në Kosovë, siguria e sovranitetit dhe integritetit territorial është e garantuar dhe NATO-ja nuk do të largohet pa krijimin e ushtrisë sonë, gjegjësisht pa integrimin e Kosovës në gjirin e saj. Deri atëherë Kosova duhet të investojë më shumë në njësitë e specializuara policore, të krijojë edhe njësi të tjera që u ngajnë njësitë ushtarake, por që janë me mision policor", ka thënë Behar Selimi, njohës i çështjeve të sigurisë.

Ai ka shtuar se duhet të investohet shumë në shërbimin e inteligjencës nacionale dhe të asaj policore. "Duhet të krijohet

shërbimi i jashtëm i inteligjencës dhe të forcohet roli i Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Të gjitha këto mund të bëhen pa telashe me ndërkombëtarët dhe pa pasur nevojë ta lusim askënd, ndërkohë që këto ndryshime janë plotësisht efikase të mungesës së ushtrisë së armatosur", ka thënë Selimi.

Subjektet politike shqiptare dhe minoritetet joserbe kanë treguar unitet për këtë çështje, duke treguar gatishmëri të plotë që t'i votojnë ndryshimet e nevojshme kushtetuese për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura. Mirëpo ndryshimet kushtetuese, përveçse kërkojnë dy të tretat e të gjithë deputetëve në Kuvendin e Kosovës, kërkojnë edhe shumicën e dyfishtë, dy të tretat e deputetëve të minoriteteve. Arritja e kësaj shumice bëhet e mundur vetëm me shumicën e deputetëve serbë në Kuvend. Këta të fundit deri më tani kanë bërë me dije se janë kundër formimit të ushtrisë së Kosovës. Sipas Listës Serbe, ky proces nuk i kontribuon stabilitetit dhe sigurisë në vend.

Gjykata e Apelit ka zgjidhur 145 lëndë për korrupsion

PRISHTINË, 2 PRILL - Kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, ka deklaruar të hënën se për të gjitha ato raste në të cilat ka prova për vepra korruptive, kryerësit do të dënohen me burgim. Ai ka deklaruar se Gjykata e Apelit në vitin e kaluar, nga 161

lëndë, ka zgjidhur 145 prej tyre. "Në 2017-n kemi pasur 161 lëndë për korrupsion, 145 i kemi kryer, kurse 16 i kemi bartur. Nga to këtë vit i kemi përfunduar 11 dhe kanë mbetur edhe 5 lëndë që do të kryhen brenda muajit", ka thënë Shala në

konferencën e organizuar nga BIRN dhe "Internews Kosova", ku janë prezantuar gjetjet nga monitorimi i rasteve gjyqësore të shenjësuar për liberalizimin e vizave siç ka transmetuar emisioni "Drejtësia në Kosovë". Në pyetjen nëse do të shkojnë

njerëz në burg, ai ka thënë se "do të shkojnë në burg ai që e meriton dhe ai që vërtetohet se ka kryer vepër penale".

Në këtë konferencë kanë marrë pjesë edhe kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, kryetar i Gjykatës Supreme,

Enver Peci, ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, prokurori dhe koordinatori i KPK-së, Reshat Millaku. Pjesëmarrës ishin edhe gjyqtarë dhe prokurorë të rasteve specifike të shenjësuar, avokatë si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

FLET PËR "EPOKËN E RE", NASER RUGOVA

LDK-ja s'do të jetë pjesë e kësaj qeverie të papërgjegjshme



Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Naser Rugova, ka kritikuar koalicionin qeverisës, duke thënë se Kosova prej se është çliruar nuk ka pasur qeveri më të dobët dhe më të papërgjegjshme. Ai ka vlerësuar se nën drejtimin e këtij koalicioni qeverisës Kosova ka ngecur në të gjitha aspektet. Rugova ka hedhur poshtë mundësinë që LDK-ja të bëhet pjesë e Qeverisë Haradinaj pas largimit të Listës Serbe. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Rugova ka bërë me dije se do t'i ndërmarrin masat e nevojshme që sa më shpejt kjo qeveri të shkojë në shtëpi. Sipas Rugovës, LDK-ja më tepër se kurrë është e përgatitur për t'i filluar bisedimet për caktimin e datës së zgjedhjeve të reja

EPOKA E RE

Shqipëri HETEMI

PRISHTINË, 2 PRILL - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Naser Rugova, ka bërë me dije se sot (e martë) kjo parti do ta dorëzojë kërkesën për seancë të jashtëzakonshme lidhur me deportimin e mësimdhënësve turq nga Kosova. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se nuk mjaftojnë dy dorëheqje, por të gjithë ata që kanë marrë pjesë në një akt të turpshëm duhet të japin llogari. "Lidhur me skandalin për deportimin e mësimdhënësve

turq nga Kosova, LDK-ja i ka mbledhur 40 nënshkrime për thirrjen e një seance të jashtëzakonshme në Kuvendin e Kosovës, ku do të kërkojmë përgjegjësi nga presidenti, kryeparlamentari dhe kryeministri. Këta, si duket, nuk janë të vetëdijshëm se janë tri figurat kryesore në hierarkinë shtetërore. Do t'i thërrasim në përgjegjësi këta liderë të papërgjegjshëm si dhe duhet të formohet një komision hetimor sepse nuk mjaftojnë dy dorëheqje, por të gjithë ata që kanë marrë pjesë në një akt të turpshëm duhet të japin llogari", ka deklaruar Rugova.

Ai ka kritikuar koalicionin aktual, duke thënë se Kosova prej se është çliruar nuk ka pasur qeveri më të dobët dhe më të papërgjegjshme. Rugova ka vlerësuar se nën drejtimin e këtij koalicioni qeverisës Kosova ka ngecur në të gjitha aspektet. "Kosova është duke kaluar një periudhë jo të lehtë, sidomos prej ardhjes së këtij koalicioni në pushtet, i cili ka një shumicë minimale, ka një përbërje heterogjene, si dhe ballafaqohet me luftën mes partnerëve të vet koalicionit qeverisës. Në këta gjashtë muaj të qeverisjes së tij, Kosova është karakterizuar nga skandale të

mëdha dhe vendime të çuditshme. Kosova është karakterizuar edhe më përplasje në arenën ndërkombëtare, me ç'rast ka bërë hapa prapa në ndërtimin e një imazhi të mirë", është shprehur Rugova.

Ai ka hedhur poshtë mundësinë që LDK-ja të bëhet pjesë e Qeverisë Haradinaj pas largimit të Listës Serbe. Sipas Rugovës, LDK-ja më tepër se kurrë është e përgatitur për t'i filluar bisedimet për caktimin e datës së zgjedhjeve të reja. "LDK-ja nuk do të jetë pjesë e kësaj qeverie të papërgjegjshme. LDK-ja më tepër se kurrë është e përgatitur t'i fillojë bisedimet për caktimin e datës së zgjedhjeve të reja. Vetëm atëherë do të kemi qeveri dhe institucione legjitime nga vullneti i popullit të Kosovës", ka theksuar Rugova.

"Epoka e re": Z. Rugova, si i komentoni zhvillimet e fundit në skenën politike?

Rugova: Kosova është duke kaluar një periudhë jo të lehtë, sidomos prej ardhjes së këtij koalicioni në pushtet, i cili ka një shumicë minimale, ka një përbërje heterogjene, si dhe ballafaqohet me luftën mes partnerëve të vet koalicionit qeverisës. Në këta gjashtë muaj të qeverisjes së tij, Kosova është karakterizuar nga skandale të mëdha dhe vendime të çuditshme. Kosova është karakterizuar edhe me përplasje në arenën ndërkombëtare, me ç'rast ka bërë hapa prapa në ndërtimin e një imazhi të mirë. Së fundi kemi rastin e deportimit të gjashtë mësimdhënësve turq nga Kosova në mënyrë të turpshme. Dhe për këtë tre drejtuesit e shtetit, presidenti, kryeparlamentari dhe kryeministri, dalin e thonë se nuk kanë pasur informata. E gjithë kjo ka një emërues të përbashkët, se Kosova prej se është çliruar nuk ka pasur qeveri më të dobët dhe më të papërgjegjshme.

"Epoka e re": Çfarë do të bëjë LDK-ja lidhur me këtë rast, apo ka mjaftuar shkarkimi i ministrit të Brendshëm dhe shefit të AKI-së?

Rugova: Mund t'i shkarkojmë

Thaçin, Veselin, Haradinajn, ministrat dhe përgjegjësit e sektorëve të sigurisë, por kurrë nuk mund ta heqim turpin e madh që i është bërë Kosovës dhe popullit të saj. Nuk mund të hiqet turpi që ka bërë ky pushtet i papërgjegjshëm në raport me mësimdhënësit turq në Kosovë. Mos të harrojmë se këta përgjegjës institucionalë të Kosovës kanë qenë vetë azil në Zvicër në vitet e '90-ta dhe paramendojeni sikur Zvicra t'i kthente në Kosovë tek regjimi i Millosheviqit. Meqë drejtuesit e shtetit nuk kanë pasur informata për këtë skandal, atëherë kjo tregon se ata janë të paafte për ta udhëhequr shtetin. Integriteti, autoriteti dhe sovraniteti i shtetit janë shkelur me rastin e deportimit të mësimdhënësve turq. Për ta udhëhequr shtetin nuk mjafton të kesh muskuj, por duhesh të kesh dije, vizion, përgjegjësi si dhe ta duash vendin e ta respektosh Kushtetutën. Lidhur me skandalin për deportimin e mësimdhënësve turq nga Kosova, LDK-ja i ka mbledhur 40 nënshkrime për thirrjen e një seance të jashtëzakonshme në Kuvendin e Kosovës, ku do të kërkojmë përgjegjësi nga presidenti, kryeparlamentari dhe kryeministri. Presidenti në një konferencë për medie u soll si një lider partie dhe jo si president i vendit që do të duhej ta reflektonte unitetin e popullit. Kurse kryeparlamentari dhe kryeministri u sollën sikur të ishin maturantë apo tinejxherë të papërgjegjshëm. Këta, si duket, nuk janë të vetëdijshëm se janë tri figurat kryesore në hierarkinë shtetërore. Kërkesa për këtë seancë do të dorëzohet qysh sot (e martë) dhe seanca





duhet të mbahet brenda 48 orëve. Do t'i thërrasim në përgjegjësi këta liderë të papërgjegjshëm si dhe duhet të formohet një komision hetimor sepse nuk mjaftojnë dy dorëheqje, por të gjithë ata që kanë marrë pjesë në një akt të turpshëm duhet të japin llogari. LDK-ja nuk do të bëjë kompromis ndaj veprimeve të papërgjegjshme të kësaj qeverie.

"Epoka e re": Do të kërkonti shkarkimin e krerëve të shtetit?
Rugova: Tashmë kjo qeveri ka rënë sepse e ka humbur shumicën. Kjo qeveri moralisht ka rënë për tokë dhe, po të kishte vetëm pak përgjegjësi morale, do të jepnin dorëheqje të gjithë. Qeveria aktuale e ka humbur kredibilitetin moral. LDK-ja tani si subjekti më i fuqishëm në vend dhe si grupi më i madh parlamentar do ta rrezojë këtë qeveri dhe këtë koalicion të papërgjegjshëm. Duke ia liruar vendin një procesi të ri zgjedhor, i cili do të rezultonte me një qeveri të përgjegjshme. Lideri aktual i Kosovës është më i papërgjegjshmi në historinë më të re të Kosovës.

"Epoka e re": Kur do ta inicioni mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë Haradinaj, dhe a e keni mbështetjen e partive të tjera në opozitë?
Rugova: LDK-ja është lokomotiva e opozitarizmit në Kuvend dhe si partia më e madhe në vend do t'i përdorim të gjithë mekanizmat kushtetues dhe ligjorë në mënyrë që këtë qeveri të papërgjegjshme ta largojmë nga pushteti. Deri më tani është dëshmuar se LDK-ja është partia më serioze në

shtetndërtimin e Kosovës. Do të bëjmë çmos që ta ndërpresim fundosjen e vendit prej kësaj qeverie. Nën drejtimin e këtij koalicioni qeverisës Kosova ka ngecur në të gjitha aspektet. Duke i respektuar kompetencat kushtetuese dhe ligjore do ta dërgojmë në shtëpi këtë qeveri. Do t'i ndërmarrim masat e nevojshme që këtë qeveri të papërgjegjshme ta dërgojmë në harresën e historisë së Kosovës sepse e ka dëmtuar vendin, proceset si dhe ka rrënuar imazhin e shtetit.

"Epoka e re": Megjithatë, pas largimit të Listës Serbe në opinion është përfolur mundësia se LDK-ja mund të bëhet pjesë e kësaj qeverie. Ka gjasa të ndodhë një gjë e tillë?
Rugova: Ky është spekulim. LDK-ja nuk do të jetë pjesë e kësaj qeverie të papërgjegjshme. LDK-ja më tepër se kurrë është e përgatitur t'i fillojë bisedimet për caktimin e datës së zgjedhjeve të reja. Vetëm atëherë do të kemi qeveri dhe institucione legjitime nga vullneti i popullit të Kosovës.

"Epoka e re": I konvenon LDK-së shkuarja në zgjedhje në mungesë të liderit të saj, Isa Mustafa?
Rugova: Kryetari Mustafa e ka një problem shëndetësor dhe kemi informata se ai për çdo ditë është duke bërë më mirë dhe duke u shëruar. Presim që këto ditë ai të kthehet në Kosovë. LDK-ja është më e përgatitur se kurrë që të shkojë në zgjedhje dhe jemi të bindur se jemi alternativa e vetme për ta udhëhequr shtetin e Kosovës.

Kryeministri Ramush Haradinaj i është kundërpërgjigjur presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan

Haradinaj: Askush nuk mund të përzihet në punët e brendshme të Kosovës

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, më në fund ka dhënë përgjigje për akuzat e Erdoganit, i cili ka thënë se Haradinaj do të duhet të japë llogari për shkarkimin e ministrit të Brendshëm dhe të drejtorit të AKI-së. Në një organizim me rastin e vitit të Skënderbeut, Haradinaj ka thënë se asnjëherë nuk është përzierë në punët e Turqisë. Sipas tij, është traditë të shqiptarët që askush të mos ndërhyjë në punët e tjetrit

**EPOKA
ERE**

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 2 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, i është kundërpërgjigjur deklaratës së presidentit të Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, duke thënë se askush nuk mund të përzihet në punët e brendshme të Kosovës dhe se këtë duhet ta dinë të gjithë. Haradinaj këto komente i ka bërë të hënën në promovimin e gatesave tipike shqiptare "Shije shqiptare", në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se shqiptarët respektojnë të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë, pavarësisht prej identitetit të tyre dhe se Kosova asnjëherë nuk përzihet në punët e brendshme të shteteve të huaja. "Duke përkujtuar Gjergj Kastriotin Skënderbeun, dëshmojmë se i kemi rrënjët e thella, edhe Kosova dhe krejt shqiptarët kudo që janë. Për ata që prej larg na gjykojnë, e para që mund t'i them se nuk na njohin atëherë, u mungon njohja për shqiptarët, në trojet e tyre, në atdheun e tyre. Ata bëjnë mirë që të na njohin, se atëherë

kur na njohin e dinë se kurrë nuk është në traditën tonë për të hyrë në punët e shtëpisë të dikujt tjetër. Kosova dhe unë s'kemi hyrë në punët e brendshme të Republikës së Turqisë, as në të kaluarën, as sot, as në të ardhmen, po ashtu punët tona të shtëpisë nuk do të mund t'i bëjë dikush në emër tonin në Kosovë. Këto punë kemi për t'i bërë vetëm ne. Këtë le ta dinë të gjithë", ka thënë Haradinaj.

Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, është shprehur i shqetësuar me deklaratimet e presidentit të Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, të drejtuara ndaj kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, në një kohë kur institucionet e Kosovës po trajtojnë në hollësi veprimet që çuan në arrestimin dhe deportimin nga Kosova në Turqi të gjashtë shtetasve turq. "Këto deklarata janë shqetësuese sepse vijnë nga lideri i një vendi mik, mbështetja e të cilit është dëshmuar në vazhdimësi para dhe gjatë gjithë ekzistencës së shtetit tonë. Andaj, deklaratimet e tilla nuk i kontribuojnë forcimit të miqësisë dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, për çka vendi ynë ka

qenë dhe është i përkushtuar", ka thënë Veseli.

Erdogani ka kritikuar kryeministrin e vendit për shkarkimin e ministrit të brendshëm Flamur Sefaj dhe shefin e AKI-së, Driton Gashi. Presidenti turk ka ftuar qytetarët e Kosovës të dalin dhe të protestojnë kundër Haradinajt. "Agjencia Turke e Inteligjencës me një operacion në Kosovë ka kapur gjashtë përfaqësues të Gylenit. Por, kam një pikëllim. Kryeministri i Kosovës i largoi nga detyra personin në krye të inteligjencës dhe ministrin e Brendshëm. Unë tani pyes kryeministrin e Kosovës: Me udhëzim të kujt more një hap të tillë? Prej kur fillove t'i mbrosh ata që u përpoqën t'i bëjnë grushtshteti Republikës së Turqisë? Si mund t'i ushqesh këta njerëz që kanë bërë një tentativë për grushtshteti ndaj Turqisë e cila mirëpret Kosovën si një vëlla. Do të japësh llogari edhe ti për këtë. Vëllezërit e mi kosovarë nuk i japin kredibilitet një kryeministri si ti. Vëllezërit e mi kosovarë, kosovarët që i njoh dhe i di, do të kërkojnë llogari prej teje për këtë. Unë e di edhe këtë", pati deklaruar Erdogani.



Testi i Maturës, pyetjet nuk do të jenë të njëjta në tërë Kosovën

PRISHTINË, 2 PRILL - Provimi i Maturës Shtetërore këtë vit do të mbahet në katër regjione, në katër ditë të ndryshme, e kjo është bërë me qëllim që të arrihen rezultate sa më reale dhe të ketë një administrim sa më të mirë të provimit. Edhe pse testi do të organizohet në regjione të ndara dhe jo për një ditë, edhe pyetjet e testit do të jenë të ndryshme. Kryetari i Komisionit të Maturës Shtetërore, Fehmi Hysenaj, në një intervistë për "KosovaPress" është shprehur i bindur se organizimi i maturës shtetërore në katër regjione do të jetë një formë më e mirë për administrimin e testit.

Provimi i Maturës shtetërore do të ketë 200 pyetje, ku kalueshmëria e këtij testi është 40 për qind dhe për secilin regjion pyetjet do të jenë të ndryshme.

Oë të ketë një administrim sa më të mirë të provimit, MASHT-i ka ndërmarrë edhe disa masa në mënyrë që të eliminohet mundësia e kopjimit gjatë testit.

Nxënësit nuk do të kenë mundësi që në test të hyjnë me telefona, madje këtë herë telefonat janë ndaluar edhe për administruesit.

Edhe numri i nxënësve nëpër klasa gjatë mbajtjes së provimit do të jetë i kufizuar, ku në një

klasë nuk mund të jenë më shumë se 15 nxënës.

Sikurse çdo vit, edhe këtë herë testi do të jetë i ndarë në dy ditë, ku në ditën e parë testi do të jetë nga lëndët e përgjithshme gjuhë shqipe, matematikë dhe gjuhë angleze, ndërsa ditën e dytë do të kenë pyetje varësisht nga profili i shkollimit të tyre.

Provimit të Maturës Shtetërore së pari do t'i nënshtrohet regjioni i Ferizajt dhe Gjilanit, ku në këtë regjion testi i parë do të mbahet më 28 maj, ndërsa testi i dytë më 5 qershor. Vetëm një ditë më pas, më 29 maj, provimit të parë të maturës do t'i nënshtrohet



regjioni i Prishtinës, ndërsa testin e dytë do ta mbajë më 6 qershor. Më 30 maj testin e parë, ndërsa më 7 qershor testin e dytë do ta mbajë

regjioni i Prizrenit dhe Gjakovës. Ndërsa më 31 maj testin e parë dhe më 8 qershor testin e dytë do ta mbajë regjioni i Pejës dhe i Mitrovicës.

Shoqatat e luftës kërkojnë që shtatorja e Adem Jasharit të vendoset në Prishtinë

Shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së nuk po pajtohen që Sheshi "Adem Jashari" në kryeqytet të emërohet me këtë emër nëse në të nuk vendoset shtatorja e komandantit legjendar Adem Jashari dhe të largohet monumenti i vjetër i "Vëllazërim-Bashkimit". Ndërsa nga Komuna e Prishtinës kanë thënë se për emrin e sheshit dhe vendosjen e shtatores do të vendoset në Kuvendin Komunal

PRISHTINË, 2 PRILL - Ditë më parë kanë nisur punimet për rregullimin e Sheshit "Adem Jashari" në Prishtinë, i cili gjendet në mes të ndërtesës së Kuvendit Komunal të Prishtinës dhe Kuvendit të Kosovës. Është evidente se ky shesh për vite të tëra është lënë pasdore dhe ndodhet në gjendje të keqe. Por, punimet e nisura nuk po i përkrahin organizatat e dala nga lufta.


Migjen Shala, udhëheqës i kësaj organizate dhe asamblist në Kuvendin Komunal të Prishtinës, ka thënë për "Radio Kosovën" se nuk do të lejojë të punohet pa u vendosur paraprakisht për emrin e sheshit dhe heqjen e simbolit të "Bashkim-Vëllazërimit". Shala ka theksuar se nëse kjo nuk ndodh, atëherë do të kërkojnë

që Sheshi "Adem Jashari" të zhvendoset diku tjetër. "Nëse nuk ndërrohet ai monument, pra nuk i ndërrohet sheshit emri, atëherë Sheshi 'Adem Jashari' duhet të zhvendoset diku tjetër", ka deklaruar Shala. Ndërsa Adonis Tahiri, zëdhënës i Komunës së Prishtinës, ka sqaruar se punimet do të vazhdojnë në shesh, ndërsa për emrin e tij do të vendoset në Kuvendin Komunal. "Projekti ka të bëjë vetëm me nivelizimin e sheshit dhe vendosjen e pllakave dhe nuk ka të bëjë as me statujë e as me emër. Për emrin e gjëra të tjera do të vendosë Kuvendi Komunal. Ky projekt ka të bëjë vetëm me rregullim të sheshit", ka thënë Tahiri.

Rregullimi i sheshit do të zgjasë 90 ditë, ndërsa investimet kapin shifrën rreth 312 mijë euro.



Reshitaj në Ditën Botërore të Autizmit: Të punojmë për sensibilizimin e shoqërisë



PRISHTINË, 2 PRILL (ER) - Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, ka thënë se në Ditën Botërore të Autizmit, si në çdo ditë tjetër, duhet të punojmë për sensibilizimin e shoqërisë për përkrahje ndaj fëmijëve autistë dhe integrimin e tyre në shoqëri. "Si institucione dhe shoqëri duhet të bëjmë më shumë për

këtë kategori, për trajtimin dinjitoz të tyre në qendrat ekzistuese të trajtimit dhe hapjen e qendrave të reja trajtuese në çdo komunë. Përmes programeve të veçanta të edukimit, përkrahjes financiare e integritimit në shoqëri, ne mund t'i bëjmë ata të ndihen të barabartë me bashkëmoshatarët e tyre. Ata kanë nevojë për mbështetjen,

respektin dhe dashurinë tonë", ka thënë ministria Reshitaj.

Ndërkaq avokati i Popullit, Hilmi Jashari, ka thënë se institucionet përkatëse duhet t'i plotësojnë kushtet e kërkuara me ligj, për të mundësuar që edhe fëmijët me autizëm mësimet në shkollë t'i vijnë në përputhje me nevojat e tyre specifike.

Opozita i rikthehet retorikës për zgjedhje të parakohshme

PRISHTINË, 2 PRILL - Me daljen e Listës Serbe nga Qeveria e Kosovës, koalicioni qeverisës ka humbur shumicën në Kuvend dhe ka nxitur reagimin e shpejtë të një pjese të spektrit opozitar për zgjedhje të parakohshme. Por, bazuar në gjendjen aktuale, Qeveria nuk e ka shumicën, por as opozita nuk i ka 61 votat e nevojshme për rrëzimin e Qeverisë, po qe se asaj nuk i bashkohet Lista Serbe.

Subjekti politik që po inkurajon pjesën tjetër të spektrit politik në Kuvend për zgjedhje të parakohshme është Lidhja Demokratike e Kosovës, e cila, ndonëse në opozitë, tash për tash përbën grupin më të madh parlamentar.

Deputeti Arben Gashi nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka thënë për "Radion Evropë e Lirë" se një Qeveri e pakicës nuk mund ta udhëheqë vendin andaj, sipas tij, vendi duhet të shkojë në zgjedhje sa më parë. "Kur ka krizë politike dhe humbje të legjitimitetit, rruga më e drejtpërdrejtë dhe më e shkurtër e rikthimit të legjitimitetit dhe përfaqësimit demokratik dhe institucional është ajo përmes zgjedhjeve. Në këto rrethana, LDK-ja preferon të shkohet në zgjedhje në mënyrë që të kemi institucione legjitime dhe përfaqësuese", ka

thënë Gashi.

Ndërsa kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, njëherësh kryetar i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në deklaratimet e tij për media ka thënë se nuk po i sheh shumë serioze propozimet për zgjedhje të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ai ka theksuar se nuk e di se sa janë të gatshëm kolegët e tij nga opozita për zgjedhje, apo janë duke bërë thirrje vetëm për të përfutur pikë politike.

Por, deputeti Arben Gashi thotë se nga zhvillimet e fundit në Kosovë është krijuar një situatë e cila mund ta dëmtojë shumë të ardhmen demokratike të vendit. Andaj, sipas tij, duhet gjetur zgjidhje të cilat e kthejnë funksionimin e institucioneve të shtetit. "Jemi në një situatë të ndjeshme, sidomos zhvillimet e javës së fundit kanë vërtetuar se kjo Qeveri veç se ka humbur legjitimitetin demokratik dhe arsyeshmërinë e përfaqësimit. Nuk ka kontroll mbi institucionet e veta dhe nuk ka koordinim me institucionet ndërinstitucionale, me institucionet të cilat janë të ndërvarura si Agjencia Kosovare e Inteligjencës apo Policia e Kosovës, apo bashkëpunimi në mes të presidentit dhe kryeministrit, apo marrja e kompetencave në mënyrë arbitrare nga

presidenti e të tjera. Pra, është krijuar një situatë e rëndë në Kosovë", ka thënë Gashi.

Ndërsa Lëvizja Vetëvendosje, e cila po kalon një moment të vështirë pas largimit të një numri të madh të deputetëve dhe zyrtarëve të saj, konsideron se ka shumë arsyeje pse kjo Qeveri duhet të dorëhiqet.

Tinka Kurti nga zyra për media në Vetëvendosje ka theksuar për "Radion Evropë e Lirë" se ky subjekt politik qëndron prapa kërkesës që kjo Qeveri duhet të bjerë sa më shpejt. "Kjo Qeveri, me të ardhur në pushtet, ka bërë një sërë skandalesh dhe duhet të bjerë për shkak se e ka sjellë marrëveshjen për demarkacion në Kuvend, marrëveshje shumë e dëmshme. Po ashtu, kjo Qeveri duhet të bjerë për shkak të ngritjes së pagave për vetveten, për shkak të numrit të madh të zëvendësministrave, për shkak se ka ndërprerje të mëdha të energjisë eklektike, për shkak të përjashtimit të Agjencisë Kosovare të Akreditimit nga regjistri i cilësisë. Të gjitha këto dhe gjendja e përgjithshme e papunësisë dhe varfërisë janë arsye që kjo Qeveri duhet të japë dorëheqje sa më parë dhe vendi të shkojë në zgjedhje të reja", ka thënë Kurti.

Ndërsa analisti politik Petrit

Zogaj ka thënë se kërkesat e partive politike opozitare për të shkruar në zgjedhje të reja janë kërkesa standarde. Sipas tij, nëse këto parti politike vërtet duan të shkojnë në zgjedhje, atëherë duhet t'i nisnin edhe procedurat e nevojshme. "Kjo opozitë duhet të dëshmojë nëse qeverisja e Ramush Haradinajt nuk e ka shumicën parlamentare, pra që të thërret për mocion mosbesimi dhe në atë mocion mosbesimi të fitojë opsioni opozitar, të fitojë LDK-ja, në këtë rast iniciativa e saj dhe Qeveria të bjerë menjëherë. Pra, nuk mjafton të thuhet se duhet të shkohet në zgjedhje, por duhet të iniciohet mocioni i mosbesimit", ka thënë Zogaj. Ai theksuar se nuk ka një kohë të përshtatshme ose të papërshtatshme për zgjedhje të parakohshme kur ka kriza të mëdha. "Aktualisht nuk shoh se jemi në një krizë shumë të madhe, megjithëse ka një shkëputje të zinxhirit institucional, por nuk shoh që medoemos situata e javës së kaluar me dy situatat problematike që i kishim, të prodhonin krizë qeveritare dhe të shkohet në zgjedhje të parakohshme", është shprehur Zogaj.

Në LDK thonë se përfaqësuesit e partive politike duhet të takohen sa më parë që të bisedojnë

për një proces të shpejtë zgjedhor. Një opsion tjetër që i krijon shumicën Qeverisë, pa pasur nevojë të shkohet në zgjedhje, është që një subjekt opozitar, në këtë rast edhe LDK-ja, t'i bashkohet koalicionit qeverisës. Por, deputet Arben Gashi e përjashton çdo mundësi që LDK-ja t'i bashkohet Qeverisë Haradinaj. "LDK-ja merr përsipër proceset vetë dhe normalisht krijon koalicionet mbi bazën e të cilave do t'i çojë proceset përpara, por duke iu prirë atyre, jo duke iu bashkuar një Qeverie jolegjitime të një kryeministri të pakicës, një kryeministër të një partie me 10 deputetë. LDK-ja nuk mund të bëjë një veprim të tillë sepse është në dëm të përfaqësimit legjitim demokratik dhe është në dëm të Kosovës dhe LDK-së", ka thënë Gashi.

Në LDK potencohet se karshi kësaj situatë të re të krijuar, edhe partitë e tjera opozitare duhet të reflektojnë sepse Qeveria nuk mund ta udhëheqë vendin me numër të pamjaftueshme të votave në Kuvendin e Kosovës. Pas konfirmimit të largimit të Listës Serbe, Qeveria e Kosovës, e cila ishte zgjedhur me 61 vota në Kuvend, edhe zyrtarisht tani mbetet në kuotën e 51 votave, që nënkupton se e ka humbur shumicën.



Rusinovci: Bujqësia në Kosovë po karakterizohet me rënie të prodhimit



Profesori i Bujqësisë, Imer Rusinovci, në një bisedë për gazetën "Epoka e re", ka thënë se bujqësia në Kosovë po karakterizohet me rënie të prodhimit. Sipas tij, nëse kjo situatë vazhdon, do të ketë rritje të importit të prodhimeve bujqësore

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 2 PRILL - Profesori i Bujqësisë në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", Imer Rusinovci, në një bisedë për gazetën "Epoka e re", ka thënë se bujqësia në Kosovë po karakterizohet me rënie të prodhimit. Sipas tij, kjo situatë është shqetësuese dhe, nëse edhe më tutje vazhdon, do të ketë rritje të importit të prodhimeve bujqësore. "Prodhimtaria bujqësore në përgjithësi dhe ushqimi për konsumatorë në veçanti, është një nga problemet më të mëdha që aktualisht shqetëson popullatën. Duhet të jemi pjesëmarrës aktivë si në prodhimtarinë bujqësore, po ashtu edhe në sigurinë ushqimore, që të konsumojmë ushqim të

shëndetshëm. Pjesëmarrja e prodhimit të ushqimit nga prodhimtaria vendore aktualisht sillet midis 40-50 për qind, dukuri kjo shumë e ulët në raport me periudhën e para 30 vjetëve kur ushqimi nga resurset tona sigurohej mbi 70 për qind", ka thënë Rusinovci, duke shtuar se bujqësia në Kosovë po karakterizohet me rënie të prodhimit. Sipas tij, nëse kjo situatë vazhdon do të ketë rritje të importit të prodhimeve bujqësore. "Për shkak të pamjaftueshmërisë së zhvillimit të industrisë agro-ushqimore dhe mungesës së rregullimeve kontraktuese, rreziqet dhe pasiguritë mund të jenë të konsiderueshme. Në deficitin e përgjithshëm tregtar të vendit, pjesëmarrje të konsiderueshme përfaqësojnë prodhimet bujqësore. Deficiti i

prodhimeve bujqësore për kokë të banorit në Kosovë është mbi 200 euro, ndërsa në vendet e BE-së është 71 euro për kokë të banorit", ka deklaruar ai.

Rusinovci ka theksuar se bujqësia mbetet aktiviteti kryesor ekonomik që siguron zhvillimin e harmonizuar të fshatrave. "Bujqësia është pasuri kombëtare që përfaqëson forcë shtytëse për ekonominë tonë të brishtë, e cila zonave rurale mund t'u sjellë një zhvillim shumë më të madh, duke zgjeruar horizontin e vëmendjes ndaj viseve rurale dhe duke trajtuar fshatrat në mënyrë të posaçme. Bujqësia mbetet aktiviteti kryesor ekonomik që siguron zhvillimin e harmonizuar të fshatrave. Viset rurale po karakterizohen me zhvendosje të mëdha të popullsisë drejt zonave urbane me tendencë të shpopullimit masiv dhe rrënimit ekonomik të shumë fshatrave. Aktualisht ndodhemi në këta kufij dhe rruga më e mundshme për të mos lejuar përkeqësimin e këtyre parametrave është zhvil-

limi i bujqësisë, duke i shfrytëzuar potencialet dhe resurset e paangazhuara deri më tani. Fuqia punëtore, toka, kjo pasuri kolosale, pyjet dhe kullotat që kemi, agroturizmi etj., janë potenciale që më mirë se kushdo i zgjon dhe i energjizon zhvillimi i bujqësisë", është shprehur Rusinovci.

Ai ka pohuar se është i nevojshëm harmonizimi i politikave bujqësore në mënyrë që të ulët debalanci tregtar i prodhimeve bujqësore. "Politikat e bujqësisë dhe ushqimit duhet t'i kenë parasysh problematikat aktuale dhe metodat e zgjidhjes së problemeve. Politikat për bujqësi dhe ushqim mund t'i zgjidhin problemet kronike që ndeshen në prodhimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore. Këto politika dhe programe duhet të evoluojnë në mënyrë graduale në përgjigje të ndryshimit të përmasave dhe karakterit të problemeve", ka thënë Rusinovci, duke shtuar se politikat për bujqësi dhe ushqim duhet të konsistojnë në ekonomi të shëndetshme dhe

shëndet të konsumatorëve, kriter ky që duhet të jetë primar. "Andaj prodhimtarinë bujqësore duhet ta mbështesim, duke ndikuar në imunitetin e goditjeve nga konjunkturaktuale, përmes politikave të duhura, me veçim të politikave ekonomike nga ato strukturore. Nëse sektorin e bujqësisë e strukturojmë mirë, kjo pa dyshim do të koïncidonte me ekonomi të shëndoshë të vendit, me investime të nivelit përkatës në bujqësi, edhe me reduktim të madh të importit", është shprehur ai. Sipas Rusinovci, në saje të mungesës së rregullimeve kontraktuese në fushën e bujqësisë rreziqet dhe pasiguritë janë të konsiderueshme. "Kjo po na koïncidon me mosmundësitë që të aktivizojmë 35-40 veprimtari të industrisë ushqimore, ku do të hapeshin vende të reja pune, sidomos në zonat rurale, me ç'rast invazionet e popullatës në zonat urbane do të ndaleshin dhe do të eliminoreshin shumë probleme sociale", ka deklaruar profesori i Bujqësisë, Imer Rusinovci.

Tarifa që godet ekonominë

PRISHTINË, 2 PRILL - Vendosja e tarifës për qarkullim në autostradën "Rruga e Kombit", e cila po has në kundërshtime të shumta, sipas ekspertëve të fushave ekonomike dhe përfaqësuesve të bizneseve, do të ndikojë në përkeqësimin e marrëdhënieve tregtare ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.

Të dyja vendet në vitet e fundit kanë nënshkruar marrëveshje të shumta bashkëpunimi të cilat kanë për qëllim rritjen e shkëmbimeve tregtare por, të cilat, sipas vlerësimeve të deritashme, nuk kanë arritur efektet e duhura për shkak të barrierave që vendet ua kanë vënë njëra-tjetrës në vazhdimësi.

Eksperti i çështjeve ekonomike, Naim Gashi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se tarifa rrugore është një goditje shumë e rëndë e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve. "Vëllimi tregtar ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë është dhjetë herë më i ulët sesa me Serbinë dhe vendosja e taksës rrugore do ta reduktojë edhe më shumë këtë vëllim tregtar. Qeveria e Shqipërisë po merr veprime konkrete të cilat po e frenojnë rritjen e vëllimit tregtar dhe bashkëpunimit ekonomik

ndërmjet dy vendeve", ka thënë Gashi.

Sipas vendimit, i cili pritet të hyjë në fuqi së shpejti, të gjithë ata që udhëtojnë në "Rrugën e Kombit", në pjesën e Shqipërisë, do të paguajnë tarifë nga 2.5 euro për motorët, 5 euro për veturat dhe deri në 25 euro për kamionët e tonazhit të rëndë.

Të dhënat zyrtare tregojnë se vlera e importit të produkteve të cilat importohen nga Shqipëria në vit tejkalon shumë prej 99 milionë eurosh, derisa vlera e produkteve të Kosovës që eksportohen në Shqipëri është vetëm 15 milionë euro.

Berat Rukiqi nga Oda Ekonomike e Kosovës ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se do të duhej të kishte taksë, por ajo të jetë e arsyeshme, pasi tarifa e caktuar do të ketë ndikim negativ në aspektin ekonomik. "Një vendim i cili kur është marrë nuk ka trajtuar shumë aspekte. Ka qenë jotransparent dhe ka një strukturë të taksave që janë mjaft të larta qoftë për qytetarët, qoftë për biznesin. Pjesa më e madhe që preken nga kjo taksë janë qytetarët e Kosovës. Nëse kjo taksë mbetet dhe nuk ka alternativë së paku do t'i bëjë produktet më pak konkurruese. Por, unë



mendoj se ende ka hapësirë që Qeveria e Shqipërisë të gjejë një modalitet që nuk i dëmton as qytetarët e as bizneset", ka thënë Rukiqi.

Sipas të dhënave të Policisë kufitare të Kosovës dërguar "Radios Evropa e Lirë", vetëm në vitin 2017 në kufirin me Shqipërinë janë regjistruar mbi 2 milionë hyrje dhe dalje të automjeteve, kamionëve dhe autobusëve.

Vendimi i Qeverisë së Shqipërisë

për vendosjen e tarifës për qarkullim në autostradën "Rruga e Kombit" ka nxitur reagime të mëdha edhe në Shqipëri.

Qytetarë të Shqipërisë të shtunën kanë protestuar për ta kundërshtuar taksën dhe kanë shkatërruar tërësisht kabinat e pagesës së tarifës, duke i goditur me mjete të forta dhe duke ua vënë zjarrin.

Në shenjë pakënaqësie, kundër këtij vendimi gjatë javës së kaluar edhe disa kompani private

nga Kosova që importojnë produkte nga Shqipëria kishin protestuar në pikën kufitare në Vermicë. Përveç tarifës rrugore që ka vendosur shteti i Shqipërisë, edhe shteti i Kosovës pritet të vendosë një tarifë të tillë për pjesën e autostradës së Kosovës. Ministria e Infrastrukturës është në procedurë të fizibilitetit, por është thënë se kjo tarifë do të jetë simbolike dhe do të përputhet me kushtet ekonomike të qytetarëve të Kosovës.

Në Prishtinë janë mbi 46 mijë ndërtime pa leje



PRISHTINË, 2 PRILL (ER) - Kosova ka identitet arkitektonik, megjithatë ka nevojë për më shumë hapësirë krijuese në zhvillimin e mëtutjeshëm të këtij identiteti. Kështu është thënë të hënën në Konferencën e parë të Ndërtimit në Kosovë "Conrecon". Ndër objektet që lidhen me identitetin arkitektonik të

Kosovës janë përmendur Pallati i Rinisë dhe Sporteve, Biblioteka Kombëtare, objekti i Kuvendit të Kosovës dhe Fakulteti Teknik.

Kryetari i Shoqatës së Arkitektëve të Kosovës, Astrit Nixha, ka thënë se ka objekte të rëndësishme në Prishtinë që edhe vetë njerëzit që i shfrytëzojnë nuk ua dinë vlerat. Ai ka

përmendur objektin e vjetër të Akademisë së Arteve, ku ish-kryetari i kësaj akademie kishte kërkuar që objektit t'i shtohet edhe një kat.

Ndërsa kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka thënë se investimi në infrastrukturë siguron zhvillim të qëndrueshëm. Në këtë konferencë ka marrë

pjesë edhe drejtori i Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, Ardian Olluri, i cili ka potencuar se në Prishtinë janë mbi 46 mijë ndërtime pa leje. "Sot në Prishtinë kemi mbi 46 mijë ndërtime pa leje, kurse leje të përdorimit 3 për qind. Komuna ka qenë e angazhuar t'i ndalë ndërtimet pa leje, kemi arritur të ndalim këtë. Por janë trajtuar

vetëm 500 e janë legalizuar vetëm 300", ka thënë Olluri. Nën kryetari i Prishtinës, Selim Pacolli, ka vlerësuar se organizimi i konferencave të tilla ndihmon në planifikim më të mirë të ndërtimeve në kryeqytet. Konferenca "Conrecon" do të zgjasë dy ditë dhe do të marrin pjesë shumë arkitektë e inxhinierë nga Kosova e rajoni.


Nëntëmbëdhjetë vjet pas rënies, kujtohet dëshmori Salih S. Bytyçi dhe të flijuarit e Shkozës, Baba Lushë...

Ju nuk keni vdekur, ju jetoni përjetësisht!

Jusuf M. BYTYÇI

Nëntëmbëdhjetë vjet më parë, në fillim të javës së dytë të sulmeve ajrore të NATO-s kundër caqeve dhe objektivave serbe në Kosovë dhe në Serbi, barbarët serbë u hakmorën ndaj civilëve shqiptarë. Pikërisht si rezultat i ndërhyrjes së drejtë të NATO-s ndaj Serbisë e caqeve serbe në Kosovë, forcat serbo-çetnike u hakmorën ndaj civilëve shqiptarë në çdo lokalitet të Kosovës. Kjo ndodhi edhe në Komunën e Malishevës, respektivisht në fshatin Shkozë. Pas masakrës së 31 marsit në Burim, ku u vranë dhe masakruan afër 40 civilë, banorë të fshatrave Dragobil e Astrazup, barbarët serbë, vazhduan "gjahun" në fshatrat e tjerë të kësaj komune. Mes 1 e 2 prillit të vitit 1999 kriminelët serbë, pasi kishin djegur e shkatërruar çdo shtëpi-vatër dhe pronë në fshatin Shkozë e në fshatin fqinj Jançist, kanë vrarë dhe masakruar edhe banorët më të moshuar të këtyre dy fshatrave. Në malet e Shkozës kriminelët që kishin depërtuar edhe në pyjet më të dendura e tatëpjetë, kanë vrarë dhe kanë masakruar pleqtë Alush Limanin-Babën Lushë, më i madhi në familjen Mjeku, si dhe Avdullah Ukën, nunin Dull, të dy 82 vjeç.

Në kundërpërgjigje ndaj veprimeve kriminale të forcave serbe, më 2 prill, në Shkozë, ra ish-ushtari i UÇK-së, Salih S. Bytyçi, dëshmor kombi. Po më 2 prill në Shkozë e rrethinë ishte vrarë edhe civili - invalid Hamit



Meta, që s'ishte larguar fare nga shtëpia. Ndërsa në afërsi të fshatit Jançist, barbarët kanë vrarë dhe kanë masakruar edhe dy bashkëshortë Sopaj, Hanifen dhe Rexhepin, 3 të moshuar të tjerë Sopaj e Krasniqi nga ky fshat, Islamin, Arifin dhe Mustafën, bariun Ibish I. Bytyçin, nga Shkoza, rreth 60 vjeç. Janë vrarë e masakruar edhe dy gra nga ky fshat, e ëma Hatmane dhe e bija Bademe Bytyçi, rast i ndodhur në Bellanicë. Lidhje me këto data, në Shkozë, më 2 prill, zakonisht shënohet dita e rënies së dëshmorit Salih Selman Bytyçi, Dita e Shkollës së fshatit, që mban emrin e këtij dëshmori, si dhe Dita e të Flijuarve të Shkozës.

Baba Lushë ishte i veçantë. Pos që ishte më i vjetri në lagjen e Mjekëve, ishte edhe kryefamiljar, ishte më i respektuar edhe në fshat. Si njeri i përjetimeve të

rënda në Luftën e Dytë Botërore e në kohën e regjimit komunist, është dëshmuar për virtyte të një njeriu përparimtar, inteligjent, me vizion, i guximshëm dhe shumë këshillues për të ardhmen. Ai e deshi arsimin shqip, e deshi dhe kontribuoi për shkollën, për ndërtimin e infrastrukturës së fshatit, e deshi lirinë, e deshi Pavarësinë, e deshi shumë Shtetin, për të cilin edhe u flijua.

Si i tillë, Baba Lushë mbahet mend nga të gjithë ata që e njohën. Babën Lushë s'e harrojmë kurrë. Ai e meritonte këtë respekt, e meriton për ta mbajtur mend dhe për ta kujtuar gjithmonë. Baba Lushë, i thoshin edhe më të rinjtë e gjithë fshatit Shkozë. Lavdi jetës dhe veprës së dëshmorit Salih S. Bytyçi! Lavdi jetës dhe veprës së të flijuarve të tjerë!



Lavdi jetës dhe veprës së Babës Lushë!

Ju nuk keni vdekur, vetëm keni ndërruar jetë! Ju jetoni përjetësisht me ne!

Në përkujtim të dëshmorit Salih S. Bytyçi, si dhe të civilëve të

flijuar nga Shkoza, të hënën, Nëndega e OVL të UÇK-së nga Shkoza dhe familja e dëshmorit bënë nderim te varri i dëshmorit Salih S. Bytyçi, në varrezat e dëshmorëve në Malishevë, ku vunë buqeta me lule.

Vetëvendosja akuzon Ahmetin se po mbështet shkeljet ligjore në NPB

PRISHTINË, 2 PRILL (ER) - Grupi i asamblistëve të Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë kanë drejtuar kritika ndaj kryetarit të kryeqytetit, Shpend Ahmeti. Asamblistët e LV-së në Prishtinë e kanë akuzuar Ahmetin se është duke tentuar të bëjë shkelje të ligjit për 'kapjen e Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB)'.

Asamblistja e Vetëvendosjes, Leonora Bajraktari, në një konferencë për medie ka thënë se drejtori i Drejtorisë së Pronës në Komunën e Prishtinës, Dren Kukaj, së bashku me aksionarin tjetër, Qëndrim Sahitin, kanë caktuar katër anëtarë të përkohshëm të Bordit të Drejtorëve të NPB në Prishtinë. "Me të njëjtin vendim ata urdhërojnë po këtë bord me katër anëtarë të jashtëligjshëm të

përpilojnë një përmbledhje të gjendjes së NPB-së por, sipas statutit të kësaj ndërmarrje, pika 26.4, çdo takim i bordit të drejtorëve me stafin administrativ të ndërmarrjes është në kundërshtim me parimet e qeverisjes së korporatave. Ky vendim është i kundërligjshëm dhe i pazbatueshëm, pasi me ligjin 03 L 087 të datës 13. 6. 2008 për ndërmarrjet publike, komisioni komunal i aksionarëve për ndërmarrjet publike nuk ka të drejtë të emërojë me mandat të përkohshëm anëtarët e bordit të drejtorëve", ka thënë Bajraktari. Ajo ka theksuar se emërimi ad-hoc i disa individëve si anëtarë të përkohshëm të bordit të drejtorëve, duke mos respektuar konkursin e shpallur nga vetë komisioni komunal aksionar,



është i paarsyeshëm dhe joligjor. Ndërsa asamblisti tjetër Egzon Azemi ka thënë se NPB-ja më 22 mars të këtij viti ka shpallur konkurs të rregullt për zgjedhjen e katër anëtarëve të bordit të drejtorëve. Sipas tij, afati për

aplikim është i hapur deri më 21 prill. Azemi ka treguar se më 25 mars kanë marrë një e-mail nga drejtori i Pronës, Dren Kukaj, ku në mënyrë urdhërore, pa u përcaktuar as rendi i ditës, ka kërkuar të takohen në zyrën e tij

më 26 mars. Ai ka shprehur dyshime se të gjitha këto veprime po ndërmerren me qëllim të largimit të Nexhat Kryeziut, shefit të tanishëm të Ndërmarrjes Banesore në Prishtinë, e cila, sipas tij, është ndër ndërmarrjet më të suksesshme.

I pyetur nëse kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, qëndron prapa gjithë kësaj pas largimit të tij nga Lëvizja Vetëvendosje, Azemi ka kërkuar nga kryetari i komunës të deklarohet rreth kësaj çështje. "Çdo projekt pozitiv për qytetin do ta përkrahim, por tentimet për kapjen e ndërmarrjeve ne i kemi kundërshtuar kur e kanë bërë një gjë të tillë edhe PDK-ja dhe LDK-ja. Natyrisht se do t'i kundërshtojmë, pavarësisht se kush i bënë ato", ka thënë Azemi.

Finalja e dialogut Kosovë - Serbi



Shkëlzen MALIQI

Formati i dialogut Kosovë - Serbi, që për qëllim kishte normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve, u tregua me mangësi serioze që ndikuan në vonesa dhe moszbatim të marrëveshjeve të arritura. Dialogu zhvillohej pa afate dhe instrumente penalizuese, sepse BE-ja, si lehtësuese e dialogut, nuk e kishte autoritetin e mjaftueshëm kushtëzues.

Stimulus i vetëm për dinamizimin e dialogut ka qenë vlerësimi i sukseseve në dialog si momente shpërblyese për hapa avancues në proceset integruese. Serbia shfrytëzoi më mirë këtë ndërlidhje të dialogut me hapat e integritimit, ngase hyri në biseda për anëtarësim. Ndërkaq, Kosova ngeci shumë, duke mos e marrë madje as liberalizimin e vizave. Kjo nuk ndodhi ngase Kosova ishte më pak kooperative. Problemi ishte te mosuniteti i BE-së rreth njohjes së pavarësisë së Kosovës. Spanja, Rumania, Sllovakia, Greqia dhe Qiproja nuk e njohin pavarësinë, kështu që në çështjet e përparimeve për integrim mungonte konsensusi i duhur në instancat vendimmarrëse të BE-së.

Ngecja karshi avancimit të Serbisë ndikoi në rritjen e pakënaqësisë në Kosovë me efekte negative për procesin e

dialogut. Gjatë përplasjeve të brendshme politike në Kosovë janë fuqizuar dukshëm forcat të cilat që nga fillimi kanë qenë kundër dialogut. Atyre iu dha një argument i fuqishëm propagandues se dialogu i formatit ekzistues shkon në favor të Serbisë. Nëse vazhdohet trendi, thoshin ata, do të vijmë në situatë që Serbia të bëhet anëtare e BE-së shumë para Kosovës. Me këtë, Serbia fiton fuqi bllokuese shtesë pasi që vendimmarrja në BE është me konsensus. Nëse Serbia arrin e para në cak, e pamundëson anëtarësimin e Kosovës në BE! Kuptohet, ky skenar negativ nuk ka qenë asnjëherë intencë reale e Brukselit. Nëse jo zëshëm, atëherë me gjysmë goje zyrtarët e BE-së gjithnjë pohojn se në momentin e caktuar Serbisë do t'i kërkohet njohja e pavarësisë së Kosovës, si dhe mospengimi i anëtarësimit të saj në organizatat ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe Kombet e Bashkuara.

Rolin vetëdijesues ndaj Serbisë për qëllimin e fundit të dialogut prej kohësh e kishte marrë Gjermania, si një zëdhënëse më me ndikim e BE-së në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Është e vërtetë, pra, që Serbia ka përparuar më shpejt, i ka hapur edhe bisedat për anëtarësim, por në kapitujt e parë të bisedimeve ajo është ballafaquar me çështjen e normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën. Me këtë edhe kushtëzohet çdo përparim i mëturshëm i Serbisë drejt anëtarësimit në BE. Dhe kjo krijon mundësinë që edhe

Kosova ta zë hapin, aq më parë që njohja eksplicite ose implicite e pavarësisë së Kosovës nga Serbia do ta ndryshonte rrënjësisht situatën, sikundër që do të ndikonte edhe te pesë anëtarët e BE-së të cilat nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, që ta ndryshojnë mendjen.

Megjithatë, janë edhe dy faktorë të tjerë madhorë në zhvillimet gjeostrategjike që e kushtëzuan ndërrimin aktual të formatit të dialogut dhe caktimin me urgjencë të një afati njëvjeçar, ose 18 muaj, për arritjen e marrëveshjes gjithëpërfshirëse dhe obliguese të normalizimit të marrëdhënieve Kosovë-Serbi, që është ajo finalja e madhe e dialogut me të cilën të dy shtetet e hapin portën e BE-së.

Çështja e parë ka të bëjë me krizën e brendshme të BE-së: referendumi i Britanisë për dalje nga BE-ja, kriza e euros, borxhi marramendës i Greqisë, fuqizimi i euroskepticizmit dhe nacionalizmave në shumë shtete anëtare të BE-së... Në këtë kontekst, edhe vonesat e dialogut Kosovë-Serbi marrin hijen e të qenit pjesë e gjendjes së pasigurisë në tërë kontinentin. Për më shumë, jostabiliteti i Ballkanit perceptohet si bombë me sahat që kërcënon BE-në.

Faktori i dytë kërcënues ka të bëjë me proceset në Evropën Lindore, ku Rusia ringjalli ambicijet për ta rikthyer rolin e superfuqisë botërore, pasi që aneksoi Krimenë, e ndau Ukrainën në dysh, patronizoi shkëputjet e pjesëve të territoreve të Gjeorgjisë, intervenoi

ushtarakisht në Siri, etj.

Po kështu, duke përfituar nga vetoja në Këshillin e Sigurimit me të cilën e bllokoi Kosovën, Rusia investoi shumë që Serbinë ta fusë në orbitën e interesit të vet: bleu të gjitha resurset energjetike të saj, ndërtoi bazën ushtarake në Nish (të maskuar si "humanitare"), kontrollon mediat serbe, etj. Rusia punoi që ta vendos kontrollin edhe mbi Maqedoninë, Malin e Zi dhe Republikën Srpska, etj., mbase e udhëhequr me pretendimin që ta kthejë formulën e vjetër të ndarjes së sferave të interesit "50 me 50", sipas Paktit të Jaltës Churchill - Stalin, të vitit 1945.

Këto ndërmarrje të Rusisë gjithsesi janë sfiduese për stabilitetin dhe sigurinë e Kontinentit të Vjetër. Ndërkaq, në rajonin tonë kjo drejtpërdrejt bie ndesh me interesin e BE-së që tërë Ballkani, me të gjitha vendet që aktualisht nuk janë anëtare, të konsiderohet me të ardhme drejt BE-së, kjo e konfirmuar nga Samiti në Selanik në vitin 2003. Depërtimi i Rusisë në Ballkan kërcënon, nëse jo përçarjen, atëherë gjithsesi dobësimin e mëtejshëm të BE-së.

Perëndimi dhe NATO aktualisht janë alarmuar nga ambicijet e Rusisë, duke e ndëshkuar me sanksione. Këto zhvillime rreth Rusisë nuk mund të kalojnë pa ndikime edhe në dialogun Kosovë - Serbi, madje edhe duke imponuar dinamikë, format dhe përmbajtje të re.

Pasi që në dialogun paraprak shumica e marrëveshjeve teknike janë realizuar, ose të

paktën janë draftuar zgjidhjet e tyre, faza e re do të duhej të ishte esencialisht politike, një lloj "Strategic Endgame", që qëllimin kryesor e ka pengimin e depërtimit të Rusisë në Ballkan.

Unë jam i bindur se edhe marrëveshja finale për normalizimin e plotë të marrëdhënieve Kosovë-Serbi në pikat kryesore tashmë është draftuar. Për të biseduar kanë mbetur disa çështje ku kërkohet arritja e kompromiseve diplomatike statutores që do t'i rumbullakësonin zgjidhjet tashmë të paralajmëruara me elemente siç janë: anëtarësimi i Kosovës në OKB, zbatimi i detyrueshëm i Asociacionit të komunave me shumicë serbe me kompetenca që nuk janë ekzekutive.

Assesi nuk bëhet fjalë për marrëveshje eventuale "kompensuese" çfarë kërkon Serbia, duke përmendur ndarjen ose këmbimin e territoreve.

Kosova në këtë "Endgame" nuk do të duhej të hynte e përçarë, pa arritjen e një uniteti të shumicës shqiptare.

Kjo mund të arrihet qoftë përmes rikonstruimit të Qeverisë së koalicionit të madh, ku individët duhet të heqin dorë nga sedrat dhe ambicijet personale, qoftë duke autorizuar një Ekip të Unitetit që do t'i zhvillojë dhe përfundojë bisedimet.

(Ky editorial është shkruar në kuadër të projektit të KDI-së, "Fuqizimi i rolit të Kuvendit në mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në këtë proces", financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës)

Latifi përkujton të rënët e 2 prillit të vitit 1999

RAHOVEC, 2 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka përkujtuar të hënën të rënët e 2 prillit të vitit 1999. Ai ka thënë se me këtë datë bombat vrastare të Serbisë kanë shkakuar vdekjen e dhjetëra njerëzve të pafajshëm. "Sot me përkushtim përkujtuam 2 prillin e vitit 1999, ditën ku forcat serbe përdorën edhe aeroplanët luftarakë kundër qytetarëve të Nagacit dhe të fshatrave përreth të cilët, për të shpëtuar nga vdekja, ishin strehuar në këtë fshat. Në mëngjesin e hershëm të 2 prillit 1999 bombat vrastare shkakuan vdekjen e dhjetëra njerëzve tanë, të grave, burrave e

djemve, të pleqve e fëmijëve. Pra, Serbia terroriste po kryente sulme edhe nga ajri për të shkatërruar çdo gjë që ishte shqiptare", ka thënë Latifi. Në këtë kontekst, Latifi ka thënë se tani është detyrë e tyre ta forcojnë shtetin e Kosovës. "Në mes të dhembjes së madhe dhe krenarisë legjitime, 19 vjet pas luftës para nesh mbetet detyrë e përhershme që ta forcojmë lirinë dhe shtetin tonë që lindi nga gjaku i dëshmorëve nga Nagaci si Nesimi Elshani, Habib Gashi dhe i gjashtë të martirizuarve nga ky fshat, më 2 prill 1999. Lavdi për jetë e mot dëshmorëve dhe martirëve!", ka është shprehur Latifi.



Trumpi e ka ftuar Putinin në Shtëpinë e Bardhë

MOSKË, 2 PRILL - Një ndihmës i lartë i Kremlinit ka thënë se presidenti amerikan Donald Trump ka ftuar në një vizitë në Shtëpinë e Bardhë,

presidentin rus, Vladimir Putin. Yuri Ushakov u ka thënë agjencive të lajmeve ruse të hënën se Trumpi këtë ftesë ia ka bërë Putinit gjatë një

bisede muajin e kaluar, ku presidenti amerikan e kishte uruar për fitoren në zgjedhje presidentin rus. Shtëpia e Bardhë nuk ka komentu-

ar menjëherë këto deklarata të Ushakovit. Sidoqoftë, administrata amerikane kishte lëshuar një

deklaratë pas bisedës telefonike më 20 mars, ku thuhej se dy liderët kanë biseduar vetë për një takim të mundshëm.

Kush janë gylenistët?

Gulen proklamon se përqafton islamin e moderuar dhe tolerant. Megjithatë, disa qeveri e shohin lëvizjen e tij si kërcënim për shkak të rrjetit që ka në mesin e biznesmenëve të pasur dhe ndikimit që ushtron përmes qendrave arsimore

ANKARA, 2 PRILL - Turqia tash e një kohë të gjatë u është vënë pas mbështetësve të lëvizjes Hizmet të klerikut Fethullah Gulen, rivalit kryesor të presidentit turk, Rexhep Tajip Erdogan.

Mbështetësit e Gulenit, i cili jeton në Shtetet e Bashkuara, konsiderohen terroristë nga Turqia, ndërkaq Lëvizja Hizmet, që ka miliona mbështetës, në Turqi është shpallur terroriste. Erdogan ka fajësuar Gulenin se qëndron prapa grusht-shtetit të dështuar më 15 korrik të 2016-s në Turqi dhe prej atëherë, autoritetet turke kanë arrestuar mijëra persona dhe shumë të tjerë i kanë larguar nga puna, pas dyshimeve se janë "gylenistë" apo ndjekës të klerikut Gulen.

Çfarë bën Lëvizja e Gulenit?

Kleriku Gulen fitoi famë në vitet '60 si predikues në lutjet e së premtes. Përmes lëvizjes së tij Hizmet (Shërbim) ka financuar shkolla, media dhe organizata joqeveritare. Kjo lëvizje operon në mbi 150 shtete të botës. Në

këtë mes hyn edhe Kosova, në të cilën gjenden shkollat e arsimit fillor dhe të mesëm "Mehmet Akif".

Gulen proklamon se përqafton islamin e moderuar dhe tolerant. Megjithatë, disa qeveri e shohin lëvizjen e tij si kërcënim për shkak të rrjetit që ka në mesin e biznesmenëve të pasur dhe ndikimit që ushtron përmes qendrave arsimore. Mbështetësit e Gulenit thonë se kjo lëvizje promovon altruizmin, punën dhe edukimin.

Raportet me Erdoganin

Rivaliteti në mes të Erdoganit dhe Gulenit nuk ka ekzistuar gjithmonë. Në fakt, lëvizja e Gulenit ka qenë një mbështetëse e fuqishme e Erdoganit. Guleni, përmes medieve që e kanë mbështetur atë dhe lëvizjen e tij, ka ndihmuar që partia e presidentit turk, Partia për Zhvillim dhe Drejtësi, të vijë në pushtet më 2002.

Megjithatë, marrëdhëniet mes Erdoganit dhe Gulenit u prishën për shkak të, siç është thënë, dallimeve në çështjen e ndarjes së



pushtetit dhe për stilin autoritar të udhëheqjes së presidentit turk.

"Grup terrorist"

Në maj të vitit 2016 Turqia zyrtarisht e ka njohur lëvizjen e klerikut Gulen, si grup terrorist. Erdogan për një kohë të gjatë ka akuzuar Gulenin dhe mbështetësit e tij, se dëshirojnë të bëjnë grusht-shtet. "Ne nuk do t'i lëmë ata që përçajnë kombin", kishte deklaruar Erdogan, në ditën kur zyrtarisht organiza-

ta e Gulenit u shpall grup terrorist në Turqi, shtet në të cilin njihet me akronimin FETO (Organizata Terroriste Fethullaiste).

Akuza për grushtshtet ndaj gylenistëve, Erdogan kishte bërë pas një skandali të korrupsionit më 2013, ku ishin përfshirë disa prej bashkëpunëtorëve të tij më të ngushtë. Skandali kishte të bënte me akuzat ndaj zyrtarëve shtetërorë që ishin pasuruar duke përdorur fondet shtetërore për të blerë ari nga Irani dhe për ta ndihmuar

Teheranin që t'i shmangë sanksionet ndërkombëtare mbi programin e tij bërthamor.

Turqia vazhdimisht ka kërkuar ekstradimin e Gulenit nga ShBA-ja. Pas tentimpuçit më 2016, Ankara ka shtuar kërkesat për një ekstradim të tillë, por Uashingtoni zyrtar ka kërkuar prova që dëshmojnë për përfshirjen e Gulenit në puç. Ky i fundit vazhdimisht ka mohuar çdo përfshirje në këtë ngjarje. ShBA-ja ka thënë se nuk e njeh si organizatë terroriste Lëvizjen Hizmet.

Puigdemont flet për herë të parë pas arrestimit në Gjermani



BERLIN, 2 PRILL - Ish-lideri i Katalonjës, Carles Puigdemont, u ka bërë thirrje mbështetësve të tij ta vazhdojnë rrugëtimin derisa ai është duke u përballur me ekstradim nga Gjermania për shkak të rolit të tij në referendumin e Katalonjës për pavarësi.

I kërkuar në Spanjë për kryengritje dhe rebelim, Puigdemont ka folur për herë të parë prej kur është ndaluar

përmes një fletarrestimi evropian. Ai u ka thënë mbështetësve të tij se Spanja është duke vepruar në mënyrë autoritare.

Përkrahësit e idesë për pavarësi kanë marshuar në Berlin duke kërkuar lirin e tij.

Gjyqtarët kanë afat 60 ditë për ta shqyrtuar kërkesën për ekstradim.

Puigdemont ka folur përmes një audio-mesazhi të incizuar

nga politikani i së majtës, Diether Dehm, i cili e ka vizituar në burgun në qytetin Neumünster. "Përmes këtij mesazhi dua të them se ne duhet të vazhdojmë, duhet ta vazhdojmë rrugën tonë, t'i mbrojmë të drejtat tona, të drejta që janë njohur nga Kombet e Bashkuara përmes të cilave ne kemi të drejtë të vendosim për të ardhmen tonë", ka thënë ai.

Al-Sisi rizgjedhet president i Egjiptit

KAJRO, 2 PRILL - Abdel Fattah al-Sisi është rizgjedhur president i Egjiptit për herë të dytë. Ai ka fituar zgjedhjet me 97.08 për qind të votave.

Njoftimin se Sisi ka fituar zgjedhjet me këtë përqindje e ka dhënë autoriteti zgjedhor në Egjipt, shkruan AFP. Kryetari i këtij institucioni,

Lasheen Ibrahim, ka thënë në një konferencë për medie se dalja në zgjedhje ka qenë 41.05 për qind, nga gati 60 milionë votues të regjistruar. Ai ka

thënë se 92.73 për qind të votave kanë qenë 24 milionë të hedhura, ndërsa gati dy milionë fletëvotime kanë qenë të pavlefshme.



Veprimtari e rëndësishme e Isak Gutës kushtuar Aleksandër Moisiut

Aleksandër Moisiu, gjeniu i artit skenik botëror

Aleksandër Moisiu është artisti shqiptar me famë botërore. Ai me veprimtarinë e shkëlqyer artistike ishte në skenat e ndryshme të teatrove më të njohura të botës që nga viti 1899 dhe deri në vitin 1935

Prof. dr. Isak SHEMA

Aktiviteti kulturor, arsimor dhe shkencor i Autorit Isak Gutës është shumë i pasur dhe përfshinë spektër të gjerë shkrimesh publicistike, botime monografike skenarë filmash, dokumentarë filmikë, organizim i ekspozitave, pikturave, fotografive, hulumtime arkivore dhe organizim të programeve kulturore. Figura qendrore është ajo e artistit të madh me famë botërore, Aleksandër Moisiut.

Angazhimi shumëvjeçar për të ndriçuar sa më mirë figurën e aktorit të madh, ka qenë mision i tij i pandërprerë. Shfaqjet e programeve artistike në shumë qendra kulturore shqiptare, në shkolla, në insti-

inë e vet dhe të frymëzojë brez pas brezi artistët e talentuar për t'u marrë me artin dhe me aktivitetet kulturore.

Shkrimeve kritike dhe veprave të shumta studimore kushtuar Moisiut, i shtohet edhe seria e veprave të botuar dhe i ekspozitave të autorit Isak Guta.

Në veprën sintezë "Aleksandër Moisiu - Emblema", të botuar në vitin 2016, që përfshin tekste në 485 faqe, ai përmbledh në kuadër të Emblemës tërësinë e librave më të cilat ai ka paraqitur para lexuesve të shumtë në të gjitha trevat shqiptare dhe në diasporë shumë aspekte të rëndësishme për jetën dhe veprimtarinë artistike të Moisiut, yllit të pushuar të dramaturgjisë dhe të teatrit botëror të gjysmës së parë të shekullit XX.



në tri pjesë dhe në 19 kapituj. Në njëzet faqet e para është dhënë teksti hyrës: portreti i Moisiut, parafjala, Ideja e studimit dhe botimit, paraqitja e shkrimeve për A. Moisiun si edhe fjala e redaktorit dhe recensuesit.

Kërshërinë e lexuesve që në fillim zgjojnë tekste të pjesës së parë: Trungu familjar i Moisiut, përkatësia, origjina kombëtare e Moisiut, Vjena dhe Aleksandër Moisiu, Praga Moisiu dhe shekulli i ri, Aleksandër Moisiu dhe Berlina, Moisiu dhe bota e brendshme shqiptare, Aleksandër Moisiu dhe Lufta e Parë Botërore, Aleksandër Moisiu, figurë ideatore e artit skenik, Arti i Moisiut dhe artistët rusë, Aleksandër Moisiu - emblema e artit skenik botëror dhe Moisiu - flakadan i kombeve dhe vazhdimësi e legjendës vigane. Në vazhdim të kësaj tërësi përmbajtësore përmbledhen shkrimet për ekspozitën dyzetvjeçare të udhëtimit të Aleksandër Moisiut, e kompletuar nga autori me portrete, dokumente arkivore dhe tekste shkrimesh të ndryshme për Aleksandër Moisiun.

Në pjesën e dytë të këtij libri voluminoz, pas gjurmëve shpaloset komunikimi me imazhe. Me ditarin Moisiu, zë vend Filmografia dhe koncepti i Hamletit, nga interpretimet krijuese të Moisiut. Kapitujt e tjerë janë në funksion të paraqitjes së karakterit shqiptar të Moisiut, veçanërisht në rol in Hamletit.

Në pjesën e tretë përfshihen

përmbajtje të pasura dhe shkrime vlerësuese nga autori i librit, por dhe vështrime të

kushtuar Aleksandër Moisiut nga autorë të huaj dhe shqiptarë që nga viti 1920 dhe deri më sot, siç janë: Emil Faktor, Hans Bohm, Nehat Islami, Bardhyl Kosova, Vangjel Moisiu, Musa Ramadani, Shaqir Foniqi, Rudiger Schaper, Gjergj Vlasi etj.

Vlerësimet kritike për botimet e autorit Guta shquajnë aspekte me interes për kulturën, për shkencën, dhe veçanërisht për dramaturgjinë. Përmbajtja e serisë së botimeve është shumë e gjerë dhe me karakter enciklopedik. Autori ka arritur të paraqet angazhimet e Moisiut me rolet kryesore në teatër në qendrat më të mëdha botërore. Risetë që përfshihen në shkrimet dhe paraqitjet para lexuesve dhe publikut janë mbresëlënëse.

Figura poliedrike e Moisiut, e dashur dhe e admirueshme, është përjetësuar ashtu si edhe në veprat e tjera të autorëve shqiptarë dhe të huaj.

Aleksandër Moisiu, gjeniu i artit skenik botëror të shekullit XX, në këtë veper, si edhe në



tucione universitare ka ndikuar në edukimin arsimor dhe artistik të rinisë dhe të lexuesve. Përkushtimi i tij në vazhdimësi ka realizuar synimin që Moisiu të jetë i pranishëm në jetën kulturore në të gjitha viset shqiptare, ndërsa artisti shqiptar të shkëlqejë me madhësht-

Veprat kryesore kushtuar Moisiut janë: "I madhi midis të mëdhenjve", "Tok me Moisiun", "Pranvera shqiptare e Moisiut", "Rilindja e Moisiut", "Emblema" dhe "Moisiu dhe bëma e librit". Përmbajtja e lëndës së librit Emblema është mbarështuar

tjera kritike të studiuesve të tjerë, siç janë: Jorgo Bullo, Nehas Sopaj, Agim Selimi, Petrit Malaj, Fatmir Sulejmani, Kujtim Çashku dhe Dibran Fylli.

Në fund përmbledhet bibliografia dhe literatura. Botimet e veçanta dhe punimet

shumë botime të tjera, i pranishëm në kujtesën e përbotshme, me shkëlqimin e epokës së artit të kohës edhe në shekullin e ri, është paraqitur si Emblema e përhershme, ka simbolikën e vet dhe si e tillë, ka jehonën e madhe në kulturën shqiptare dhe botërore.

Astrologjia, çfarë është dhe sekretet e “Shenjës”!


Si përlogaritet dhe si ndikon në karakterin e njeriut

Për të pasur një horoskop të plotë, a është e mjaftueshme të dini shenjën tuaj të zodiakut? Shpesh, kur dikush flet për astrologjinë, dëgjojmë edhe pyetjen: “Po ti çfarë shenje je?”. Në të vërtetë mund të jetë një mënyrë e mirë për të thelluar njohuritë e një personi me të cilin jeni lidhur. Jo të gjithë e dinë se Horoskopi shpesh shkruhet sipas kriterëve që mund të jenë të dobishme për të lexuar përshkrimin e shenjës së këtij të fundit. Pra, i lini hapësirë kuriozitetit: le të frymëzohemi nga Yjet!

ÇFARË ËSHTË SHENJA? – Në aspektin teknik ngjitësi është pika e takimit midis horizontit dhe ekliptikës, pra rrethi që përfaqëson shtegun e dukshëm të Diellit në Sferën Qiellore në një vit. Në thelb ngjitësi tregon se cila shenjë zodiakale ishte në rritje, në momentin e saktë të lindjes sonë, në pikën e saktë ku Dielli u ngrit në mëngjes.

SI NDIKON NË PERSONALITETIN E INDIVIDIT? – Në astrologji është e mundur që ta ndash Rrethin e Zodiakut në dymbëdhjetë pjesë, të cilat janë 12 Shtëpitë Zodiakale. Pika në të cilën nis shenja e parë dhe përfaqëson pjesën e vetes, u tregon të tjerëve pikërisht personalitetin “e jashtëm”. Shpesh, “shenja” jep gjithashtu indikacione për pamjen e një personi, e cila në fakt është gjëja e parë që vërehet të tjerët kur krijohen përshtypjet e para. Njohja e shenjës së dikujt mund të jetë e dobishme për të kuptuar se çfarë e shtyn atë të sillet në një mënyrë të caktuar.

SILLOGARITET SHENJA? – Për të identifikuar shenjën tuaj, nevojitet data, vendi dhe koha e lindjes. Nëse nuk e dini orarin tuaj të lindjes nga prindërit ose nga një i afërm, mund të kërkonin nga bashkia ku keni lindur certifikatën e lindjes, e cila gjithashtu tregon orarin. Është e rëndësishme që koha të jetë sa më e saktë që është e mundur, sepse në disa raste, vetëm disa minuta ndryshimesh janë të mjaftueshme për të kaluar nga një shenjë në tjetrën. Nga koha e



lindjes, përmes disa llogaritjeve dhe përmes disa tabelave të përshtatshme, marrim kohën e lindjes, e cila varet nga disa faktorë, duke përfshirë gjerësinë dhe gjatësinë e vendit ku kemi lindur ose prezencën e mundshme të

kohës aktuale të kursimit të dritës së diellit.

Sapo e njihni kohën tuaj të lindjes, ka disa tabela speciale astrologjike në të cilat mund të kërkonin për shenjën. Kjo mund të duket komplekse, por për fat të

mirë ka shumë programe, gjithashtu të disponueshme në shumë faqe interneti, të cilat llogarisin ngjitësin automatikisht, me disa klikime. Në rast dyshimi, mund të kontaktoni një astrolog. (*gazeta-Shqip.com*)

Dieta mesdhetare mund të ngadalësojë plakjen e ADN-së



Studiuesit anglezë kanë ndjekur shëndetin e 5 mijë njerëzve për dhjetë vjet

Dihet mirë se dieta mesdhetare është e mirë. Lajm i vërtetë është se kjo dietë e ngadalëson “plakjen” e ADN-së së saj. Kjo është konfirmuar nga një studim britanik

i raportuar në faqen e internetit “In a Bottle” (www.inabottle.it) në një studim mbi të ushqyerit dhe shëndetin. Zbulimi vjen nga disa studiues të

Universitetit Exeter, në Britaninë e Madhe, të cilët kanë ndjekur gjendjen shëndetësore të rreth 5,000 njerëzve për 10 vjet, duke konkluduar se “ata që ndjekin dietën e famshme mesdhetare do të ndihmojnë që ADN-ja të qëndrojë e re dhe e shëndetshme”. Zbulimi erdhi nga vëzhgimi ‘kapakëve mbrojtës’ të ADN-së, shkurtimi i të cilëve është i lidhur me plakjen qelizore dhe sëmundjet e shumta lidhur me moshën.

Në fakt, studimi tregon se “ata që hanë sipas rregullave të dietës së Mesdheut ruajnë një organizëm më të shëndetshëm, ngadalësojnë plakjen gjenetike të kromozomeve dhe mbrojnë ADN-në nga sëmundje të ndryshme”.

Edhe nëse dieta mesdhetare ka piramidën e saj ushqimore, ku duhet të merren proporcione të drejta të perimeve, frutave, karbohidrateve dhe proteinave për një dietë të shëndetshme dhe të ekuilibruar, në bazën e saj nuk duhet të harrojmë rëndësinë e ujit për një hidratim korrekt.

Siç është konfirmuar ekspertët të Qendrës Kërkimore për Ushqimin, “hidratimi ka fituar gjatë viteve një vend të shquar brenda piramidave ushqimore të zhvilluara në çdo nivel dhe uji është një element esencial për një stil të saktë ushqimor, aq sa është raportuar si ushqim thelbësor në nivelet e rekomanduara të marrjes së energjisë dhe lëndëve ushqyese”.

(*gazeta-Shqip.com*)

JB Gill po bëhet sërish baba



JB Gill ka njoftuar se po pret fëmijën e dytë me bashkëshorten e tij, Chloe. Çifti janë prindër të djalit, Ace, trevjeçar. Ylli i X Factor,

emri i plotë i të cilit është Jonathan Benjamin Gill, ka thënë se fëmija do të vijë në jetë në muajin gusht.

Justin Bieber: Jezusi ndryshoi jetën time



Justin Bieber ka shfrytëzuar rrjetin social "Instagram" për të thënë diçka në ditën e Pashkëve. "Jezusi ndryshoi jetën time. Pashkët nuk kanë të bëjnë me një lepur, është një kujtim se Jezusi im vdiq në kryq për mëkatet e mia dhe pastaj u ngre nga vdekja

duke mposhtur vdekjen", ka shkruar këngëtari 24-vjeçar. "Unë besoj se kjo ka ndodhur dhe ndryshoi gjithçka. Unë jam i lirë nga skllavëria dhe turpi. Unë jam një fëmijë i Perëndisë dhe ai më do pikërisht këtu ku jam, si jam, për atë që jam", ka shkruar Bieber.



Kur Harper Beckham ua "vjedh" vëmendjen prindërve

Festa e Pashkëve e ka gjetur familjen Beckham në Miami. Të gjithë së bashku, Victoria, David dhe katër fëmijët e tyre, kanë marrë pjesë në festimet e zhvilluara të dielën në mbrëmje në Florida, në kuadër të festës

së Pashkëve. Derisa po shikonte finalët e tenisit të 'Miami Open Men' me vëllanë e saj të madh Brooklyn dhe babanë, David, vajza e vogël e familjes ka qenë ajo që ka tërhequr të gjithë vëmendjen.

Kevin Smith humbet peshë pas sulmit në zemër



Komediani Kevin Smith ka pësuar një sulm në zemër një muaj më parë dhe ai tani në rrjetin social në "Twitter" ka bërë një përditësim për fansat. Aktori ka treguar se ka humbur shumë peshë për shkak të largimit nga disa

ushqime si detyrim pas asaj që i ndodhi. "11 kilogramë më pak. Mjeku më tha të humbja 22 kilogramë dhe tani jam shumë afër. Ky sulm në zemër ishte gjëja më e mirë që më ka ndodhur ndonjëherë për shëndetin tim", ka shkruar Kevin.

Çokollata, mund të jetë e shëndetshme. Ja për çfarë ndihmon!

Një përmbledhje e botimeve shkencore mbi kakaon, ka konfirmuar efektet e saj pozitive në sistemin kardio-vaskular, njohëse dhe imunitare. Vetëm disa gram janë të mjaftueshme.

Pashkët nuk do të ishin Pashkët pa një vezë të bukur me çokollatë për ta thyer e për të shuar habinë. Lajm i mirë është se në mesin e të gjitha ëmbëlsirave ne mund të japim veten, pasi kjo është ndoshta më pak e dëmshme për shëndetin dhe në të vërtetë, ajo mund edhe të na bëjë mirë. Të paktën, kjo lloj shprese lind pas leximit të një raporti të veçantë me "cilësitë" e kakaos, botuar në javët e fundit në revistën "Kufij në të Ushqyer dhe Kufij në Imunologji", i cili mbledh të gjitha të dhënat e fundit mbi këtë temë në pyetjen fillestare nëse çokollata është një mik apo një armik për shëndetin. Përgjigjia duket të jetë: "Po një mik!", pasi të paktën nën kushte të caktuara, kakaoja mund të gëzohet pa u ndjerë (shumë) fajtor.

Sistemi kardiovaskular

Të dhënat më të forta në lidhje me efektet në sistemin kardiovaskular i shpjegon Mauro Serafini, kreu i laboratorit për ushqimet funksionale dhe parandalimin e stresit metabolik në Universitetin e Teramo dhe Koordinatorin special bashkë me Emilio Jirillo i Departamenti Themelor të Shkencave Mjekësore, Neurosciences dhe organet e ndjeshmërisë në Universitetin e Barit.



"Ne e dimë, për shembull, se kakaoja zvogëlon dukshëm prisionin, sidomos te ata që janë hipertensivë; është gjithashtu e dobishme për funksionin e endotelit, indit që lidh enët e gjakut dhe favorizon dilatimin e arterieve; për më tepër, zvogëlon grumbullimin e trombociteve. Këto efekte së bashku shpjegojnë të paktën pjesërisht, se përse studimet e popullsisë tregojnë se si të konsumojnë çokollatën për të ulur vdekshmërinë kardiovaskulare."

Një studiuese italiane, Vincenza Gianfredi i Departamentit të Mjekësisë Eksperimentale në Universitetin e Perugias, ka rivlerësuar të gjitha hulumtimet mbi këtë temë, kryer në një total prej 35 mijë personash. Rezultatet e publikuara shkurtin e kaluar mbi të ushqyerin, tregojnë

se konsumi i rregullt i dozave të vogla të çokollatës do të zvogëlonte rrezikun e dështimit të zemrës me rreth 15 për qind, 20 për qind të sulmit në zemër, 30 rrezikun e goditjes dhe madje 40 për qind mundësinë e sëmundjeve koronare. Efekti duket pak më i lartë tek gratë dhe siç shpjegon Gianfredi, merita është e polifenolit, element me të cilin është e pasur kakaoja. Është e pasur edhe me "catechin", të njëjtat polifenole që gjenden tek çaji jeshil, dhe flavonoidet gjithashtu.

Këto komponime veprojnë në endotelin e enëve të gjakut duke rritur prodhimin e oksidit nitrik, një vasodilator i fuqishëm që ka funksione anti-inflamatore (për shembull, redukton migrimin e qelizave të bardha të gjakut) dhe ul rrezikun e formimit plasheve arteriosklerotike. "Kakao gjithashtu

neutralizon oksidimin e kolesterolit "të keq" apo LDL, një nga faktorët më të rëndësishëm të rrezikut për zhvillimin e arteriosklerozës dhe për këtë arsye sulmet në zemër dhe tru.

"Gjëja e bukur këtu, është që marrja e polifenoleve si shtesë nuk duket të ketë efekt të njëjtin përfitim: shkurtimisht, për të pirë një kafe ose për të ngrënë një copë. Për shkak se kakao është një ushqim i vërtetë funksional, siç vuri në dukje Serafini: "Kakao përmban një përqendrim shumë të lartë të flavonoideve dhe i mban ato, pavarësisht nga metoda e përgatitjes. Kjo është arsyeja pse një sasi e vogël është e mjaftueshme: efekti antihipertensiv, për shembull, merret me pesë ose dhjetë gram formulë në ditë për tre javë. Ndikimi kalorik në këtë mënyrë është i kufizuar, por përfitimi në

arterie është i konsiderueshëm".

Përfitimet në nivelin njohës dhe në sistemin imunitar

Kërkimet e reja, megjithatë, shpjegojnë se përfitimet e polifenoleve të kakaos mund të jenë edhe më të shumta, me përfitime të mundshme në nivelin njohës dhe në sistemin imunitar. Pra, dritë jeshile për vezën e çokollatës gjatë gjithë vitit? "Jo, ajo duhet ende të mbetet një ushqim për ngjarje të veçanta"- frenon Andrea Ghiselli, president i Shoqërisë Italiane të Shkencave të Ushqimit.

Sigurisht, flavonoidet janë të mira, por në çokollatat që shumica prej nesh zakonisht hanë janë të "mbytura" në miell sheqeri dhe yndyrat shpesh për eksperimente janë përdorur në çokollata për t'i pasuruar në flavonoide ose një përqindje të lartë të kakaos, e cila nuk është për të gjithë e këndshme.

Duke ngrënë një çokollatë ose një tërësi të table të kemi në qilar shërben pothuajse gjithmonë për të marrë njëqind kalori, ndaj kështu që të ecësh me idenë se "dy çokollata janë më mirë", mund të bëhet e rrezikshme për peshën. "Dike e bindur veten se çokollata bën mirë mund të na çojë te të ngrënë me të lehtë, duke ekzagjeruar me doza të produkteve me shumë kalori: Për këtë, edhe pse është e vërtetë se çokollata mund të ketë efekte pozitive, ne duhet të kujtojmë gjithmonë se është një ëmbëlsirë dhe si e tillë ne duhet të kufizojmë konsumin", përfundon Ghiselli.

Asnjë përparim në sasinë ditore, pra, por ne ende mund të gëzojmë mirësinë e një copë çokollatë, veçanërisht nëse dimë se si të zgjedhim.

(gazeta-Shqip.com)



E rrallë

Aligatori futet në pishinën e shtëpisë, tmerrohen banorët

Një aligator ka hyrë brenda pishinës së një shtëpie në Nokomis, Florida. Zvarraniku kishte thyer derën prej xhami të verandës për të hyrë në pishinë duke tmerruar banorët e shtëpisë. Menjëherë familjarët kishin lajmëruar policinë që arriti të nxirrte nga uji aligatorin 3.3 metra.



FOTO E DITES




Pamje e bukur nga kryeqyteti i Kosovës, Prishtina.
/Foto: Granit Dinaj

E jashtëzakonshme

Rrëmbeu foshnjën dhe e hodhi brenda pusit

Policia në Indi është në kërkim të një majmuni që pretendohet se ka rrëmbyer një foshnje, që më vonë u gjet brenda një pusi në shtetin lindor të Orissas. Nëna e foshnjës e pa incidentin, por nuk arriti ta shpëtonte djalin e saj. Një i afërm gjeti trupin e foshnjës në një pus prapa shtëpisë të dielën, një ditë pasi ishte rrëmbyer nga majmuni që kishte hyrë në shtëpi.



BARSOLETA E DITËS



Taksisti dhe pasagjeri:

- Sa lekë kushton deri në aeroport?
- 25 mijë lekë.
- Po nëse e marr edhe të dashurën me vete?
- I njëjti çmim.
- E sheh zemër që nuk vlen asnjë lek...



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:30

“BLACK PANTHER” 3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

“PETER RABBIT”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.
Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

“PACIFIC RIM UPRISING” (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

“RED SPARROW” (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Schoenarts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

E sotmja do të jetë një ditë interesante, plot surpriza dhe ndryshime programi në momentet e fundit.



DEMI

Keni shumë gjëra të pazgjidhura me një koleg dhe kjo gjë do t'ju pengojë të nisni bashkë një projekt të ri dhe fitimprurës.



BINJAKËT

Keni lënë që persona të tjerë t'ju faturonjë probleme dhe punë të pazgjidhura. Situata ka degraduar dhe sot eprorët tuaj kërkojnë llogari.



GAFORRJA

Keni lënë pas dore disa çështje të rëndësishme familjare. Nuk jeni marrë sa duhet me ato detaje që mund të bëjnë diferencën.



LUANI

Sot mund të zgjidhni nga disa variante që do t'ju ofrohen. Sigurisht zgjedhja juaj do të jetë ajo më e mira dhe më e saktë.



VIRGJËRËSHA

Jeni shumë të mërzitur sot me një person që ju ka premtuar hënën, por nuk ka mbajtur asnjë nga premtimet e veta.
PESHORJA



AKREPI

Nëse sot nuk keni vendosur se çfarë do të bëni me një projekt tuajin është mirë të mos kërkonit zgjidhje nëse nuk keni ndarë me parë idenë.



SHIGJETARI

Mos jini shumë të bindur mbi çka po bëni sot, sepse kritikant që do të merrni do të vijnë edhe nga miqtë tuaj.



BRICJAPI

Jeni treguar shumë të kujdesshëm me çdo person që ka kërkuar ndihmën tuaj. Mbase sot duhet të hiqni dorë dhe të merreni me veten.



UJORI

Sot qëndroni larg qëndrimeve të prera dhe mos jepni vendime definitive. Më vonë do të pendoheni për këtë gjë.



PESHQIT

Do të bëni çdo gjë me kujdes sot dhe hapat që do të hidhni do të jenë konkretë dhe mirë të argumentuar.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

JUVENTUS - REAL MADRID

GG

BOLTON - BIRMINGHAM

3+

SEVILLA - BAYERN MUNICH

2

Morina: Feronikeli nuk heq dorë nga titulli

Tetë pikë diferencë me skuadrën lidere, Dritën, nuk e bëjnë pesimist mesfushorin Albutrint Morina. Ai ka thënë se me Feronikelin mund ta fitojnë titullin e kampionit. "Kemi mbetur paksa mbrapa skuadrës lidere, Dritës, por nuk jemi dorëzuar dhe nuk do të dorëzohemi derisa matematika në mbanë në garë për titull. Feronikeli ka skuadër shumë cilësore dhe gjithçka është e mundur për t'u arritur", ka thënë Morina për "Epokën e re"



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 PRILL - "Në ndeshjen ndaj Llapit kemi pasur në përgjithësi një ndeshje pozitive. Ne e kemi kërkuar më shumë fitoren duke krijuar edhe shumë raste shënimi, por fati nuk ishte në anën tonë dhe ndeshja përfundoi me rezultat të barabartë", ka thënë Albutrint Morina një ditë pas ndeshjes derbi në Vala Superligë në mes të Feronikelit dhe Llapit (2-2). Morina ishte autor i golit të dytë, kurse në këtë ndeshje e arriti shifrën e shtatë golave.

Edhe pse luan në pozitën e mesfushorit vetëm në sezonin pranveror, ka shënuar tre gola dhe hynë në garë edhe me shumë sulmues të elitës për numrin e

golave. "Bashkëlojtarët i kam shumë cilësorë dhe po krijojnë hapësira të mëdha që po më mundësojnë të shënoj gola. Jam i lumtur për numrin e golave të shënuara dhe më shumë kur këto gola i ndihmojnë skuadrës për të arritur deri te rezultatet pozitive", ka shtuar ai.

Aktualisht Feronikeli zë vendin e katërt në elitë me 39 pikë të grumbulluara, 8 pikë më pas se skuadra e Dritës që është lidere e klasifikimit. Pavarësisht prej kësaj difference, Morina është optimist se "Nikeli" mund të triumfojë në këtë garë. "Kemi mbetur paksa mbrapa skuadrës lidere, Dritës, por nuk jemi dorëzuar dhe nuk do të dorëzohemi derisa matematika më mbanë në garë për titull. Feronikeli ka skuadër shumë cilësore dhe gjithçka është e mundur

për t'u arritur", ka thënë Morina për "Epokën e re".

Ditë më parë në shtabin teknik të skuadrës së Feronikelit janë bërë ndryshime ku në vend të Ismet Munishit është emëruar Sylejman Starova. Lidhur me këto ndryshime, ish-mesfushori i Vëllaznimit ka deklaruar: "Për ne futbollistët është shumë e vështirë ku ndryshohen trajnerët, pasi na duhet t'i përshatemi idesë së tyre. Është herët të vlerësohet trajneri Starova, por

mund të them se ai është një emër i madh i futbollit shqiptar dhe shpresoj të arrijmë suksese". Albutrint Morina është ndër lojtarët më në formë gjatë këtij edicioni,

pasi në shumë ndeshje ka qenë vendimtar për Vëllaznimit në sezonin vjeshtor, kurse në pranverë po paraqitet mirë edhe për Feronikelin.

Të mërkurën gjysmëfinalet e Kupës

Ndeshjet e para në kuadër të gjysmëfinales së Digitalb Kupës së Kosovës në futboll do të zhvillohen pasnesër (e mërkurë) nga ora 14:00. Drenica do të jetë nikoqire e Vëllaznimit, derisa Prishtina do ta presë skuadrën e Ligës së Parë, Vushtrrinë. Ndeshjet e kthimit zhvillohen më 18 prill.

Munishi, Starovës: Të ka mbetur vetëm emri

PRISHTINË, 2 PRILL - Ish-trajneri i Partizanit, Sulejman Starova, ka debutuar me barazim si trajner i skuadrës së Feronikelit, por pas ndeshjes ka deklaruar se lojtarët e "Nikelit" nuk janë të përgatitur aq sa duhet fizikisht. Mirëpo, ndaj kësaj deklarate ka reaguar ish-trajneri i Feronikelit, Ismet Munishi. Ky i fundit ka thënë se Starovës i ka mbetur vetëm emri. "Në Superligën e Kosovës nuk ka skuadër më të përgatitur fizikisht se skuadra që kam drejtuar unë. Starova ka pasur dy javë kohë, por vazhdon të justifikohet, e



justifikimi është cilësi e të dobët. Neve po na vijnë trajnerë nga Shqipëria duke menduar se ne këtu nuk dimë asgjë por, në fakt, ata kanë vetëm emrin", ka thënë Munishi.

Shqipëria, miqësore me Kosovën më 29 maj

TIRANË, 2 PRILL - Shqipëria duket drejt përpjekjeve të fundit për ta zyrtarizuar edhe kundërshtarin e dytë, me të cilin do të përballet në miqësoret e muajit maj e, me të gjitha gjasat, përballet do të jetë Kosova. Pas ndeshjes miqësore të humbur ndaj Norvegjisë, në "Elbasan Arena", trajneri italian Christian Panucci kishte njoftuar se kuqezinjtë do të zhvillonin një tjetër minifazë përgatitore në Zvicër, përveç kësaj bëri



të ditur se kishin gjetur një kundërshtar, që më pas u mësua të ishte Ukraina e Andriy Shevchenkos, ndërsa po punohej për rivalin tjetër, njofton "tch". Tashmë mësohet se presidenti i FSHF-së, Armand Duka, ka ngarkuar njerëzit përgjegjës në Federatë me mbylljen e përgatitjeve, në mënyrë që në Zvicër, më 29 maj, Shqipëria të zhvillojë edhe një ndeshje miqësore ndaj pjesës tjetër të kombit shqiptar, Kosovës.

Promovohet libri "Organika taktike në futboll"

Prishtinë, 2 prill - Të premtën që vjen do të bëhet promovimi i librit "Organika taktike në futboll" i autorit Fetah Veliu. Promovimi do të bëhet në objektin e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe të Sportit. Ky është libri i katërt i botuar nga autori Fetah Veliu, një

ndër autorët e paktë, me profesion të trajnerit të licencuar me licencat nga UEFA dhe i njohur në opinion si njohës i mirë për zhvillimin e ngjarjeve rreth futbollit në vendin tonë, raporton "KosovaPress". Ky libër, sipas autorit, përmban

materialet e komponentit kryesor të futbollit, taktikës, ku gjithnjë, sipas autorit, futbollit i Kosovës dhe trajnerët e futbollit në Kosovë do të kenë mundësi të kenë alternativa të shumta për njohjen e substancës taktike në futboll dhe për mundësitë më të

mëdha për rritjen e potencialit në zejen e trajnerit dhe të avancimit të proceseve trajnuese në përgatitjen taktike të një skuadre futbollit gjatë një gare kompetitive dhe të prezantimit sa më të mirë në një ndeshje futboll.



Mourinho: Unitedi e meriton vendin e dytë

MANCHESTER, 2 PRILL - Trajneri Jose Mourinho ka thënë se Manchester Unitedi e meriton vendin e dytë në Premierë Ligë. Unitedi ka dy pikë më shumë se Liverpooli dhe me shumë gjasa do ta mbyllë sezonin si skuadra e dytë pas triumfuesve

të Manchester Cityt. Por, pavarësisht pre kësaj, taktikat e Mourinhos kanë marrë shumë kritika përgjatë gjithë sezonit, me disa që mendojnë se Liverpooli apo Tottenhami janë ekipe më të mira se "Djajtë e Kuq". Gjithsesi, Mourinho i

kundërshton këta zëra në vigjilje të derbit me Cityn në "Etihad Stadium". "Manchester City nuk ka rëndësi për mua. Çfarë ka rëndësi është vazhdimësia që kemi treguar këtë edicion. Që nga momenti që humbëm vendin e parë, Manchester

United ka qenë konstant dhe ka ruajtur vendin e dytë për të gjithë sezonin. Meritojmë ta mbyllim të dytët. Kemi më shumë pikë se ndjekësit dhe jemi shumë më të mirë se ata. Kjo është çështja", ka thënë Mourinho.



Sonte finalja e parakohshme Juve - Real

"Asnjë ekip nuk është i pamposhtur. Reali është një ekip i vështirë për ta mundur dhe mund të jetë favorit, por eliminatorja është 50-50. Duhet të jemi ambicioz, Juventusit është klub i madh që fiton gjithashtu tituj", ka thënë Buffoni

"Epoka e re"

TORINO, 2 PRILL - Finalistët e sezonit të kaluar në Ligën e Kampionëve, Juventusit dhe Real Madridi, përballën sonte (e martë) në Ligën e Kampionëve në kuadër të çerekfinaleve të kësaj gare, kurse kësaj radhe "Zonja e Vjetër" kërkon të hakmerret për humbjen në Cardiff (4-1). Cristiano Ronaldo është në kërkim të trofeut të pestë në këtë garë, kurse portieri legjendar i Juventusit, Gianluigi Buffon, po kërkon ta ngreh për herë të parë trofeun më të vlefshëm në futboll. Giggj Buffon ka thënë se Real Madridi nuk është i pamposhtur dhe beson se Juventusit ka gjasa të mira për të kaluar në gjysmëfinale. "Asnjë ekip nuk është i pamposhtur. Reali është një ekip i vështirë për ta mundur dhe mund të jetë favorit, por eliminatorja është 50-50. Duhet të jemi ambicioz, Juventusit është klub i madh që fiton gjithashtu tituj", ka thënë Buffon.

Ndërsa Zinedine Zidane bëri me dije se dëshira e tij ishte ta shmangë skuadrën e Juventusit, kurse lidhur me skuadrën që do të kualifikohet tutje, ka thënë se shanset janë të barabarta për të dyja skuadrat. "E shoh një ballafaqim të fortë, ashtu



FORMACIONET E MUNDSHME:

Juventus (4-3-3): Buffon, De Sciglio, Bargzali, Chiellini, Asamoah, Matuidi, Marchisio, Khedira, Dybala, Costa, Higuain.
Real Madrid (4-4-2): Navas, Carvajal, Ramos, Varane, Marcelo, Casemiro, Kroos, Modriq, Isco, Ronaldo, Benzema.

si vitin e kaluar. Juventusit është një ekip konkurrues. Do të jetë e vështirë. Shanset janë 50 % me 50 %. Ne do të shohim pas ndeshjes së parë. Juventusit ishte një klub i rëndësishëm për karrierën time. Do të kisha dashur ta shmangia Juve, por shorti na ka çuar atje. Do të përqendrohemi në këtë përballje dhe do të lë anash atë që kam jetuar atje", ka thënë Zidane.

Skuadra e Massimiliano Allegrit të shtunën e mposhti Milanin (3-1), duke e ngrehur në katër pikë epërsinë ndaj Napolit në Serinë A, kurse Reali pa problem e mposhti

Las Palmasin (0-3), por mbetet 13 pikë pas Barcelonës. Në ndeshjen tjetër që zhvillohet sonte, Sevilla do të kërkojë ta befasojë edhe Bayern Munchenin ashtu sikurse që bëri ndaj Manchester Unitedit. Në anën tjetër, Bayerni, pas fitores së thellë ndaj Borussia Dortmundit në fundjavë, synon të marrë rezultat pozitiv edhe në Spanjë për ta pasur më të lehtë kualifikimin në gjysmëfinale.

TË MARTËN TAKOHEN:
20:45 Juventus - Real Madrid
20:45 Sevilla - Bayern Munchen

Spursi ndal marshimin e Houstonit, fitojnë Warriorsi e Clevelandit

HOUSTON, 2 PRILL - Houstoni është mundur 100-83 nga skuadra e San Antonios, një përballje mes dy ekipesh pretendente për titull në Perëndim. Vendësit e dominuan takimin dhe triumfuan falë 23 pikëve e 14 rebaundeve të Aldridges, mbështetur edhe nga Gay me 21 pikë. Për Houstonin nuk mjaftuan 25 pikët e Hardenit për ta evituar humbjen, por Rocketsi qëndron në krye të renditjes. Nga kjo humbje përfiton Golden State, që mundi 117-107 Phoenixin, sfidë ku kampionët përfituan nga një pjesë e dytë fantastike për t'i mundur miqtë. Duranti realizoi 29 pikë e 11 rebaunde, mbështetur edhe nga Thompsoni me 23 pikë, një dyshje që bëri diferencën në parket. Në sekondat e fundit humbet Lakersi, që u mund në fushën e vet 84-83 nga Sacramento, ndeshje ku për miqtë u dallua Hieldi, autor i 19 pikëve. Fiton edhe ekipi i Clevelandit që, falë "triple double"



të LeBron Jamesit, 16 pikë, 13 rebaunde e 12 asistime, mundi 98-87 Dallasin, duke konfirmuar momentin e mirë që po kalon në kampionat, raporton "Telesport". Jashtë fushës fiton Oklahoma, që triumfoi 109-104 ndaj New Orleansit, sfidë ku miqtë patën një epërsi të lehtë gjatë gjithë kohës. Më i miri ishte Westbrook që realizoi një "triple double", 26 pikë, 15 rebaunde dhe 13 asistime, lider në fushë për Thunderin. Atlanta, falë 19 pikëve të Dorseyt, mundi 94-88

REZULTATET

San Antonio - Houston	100-83
Atlanta - Orlando	94-88
Brooklyn - Detroit	96-108
Cleveland - Dallas	98-87
New Orleans - Oklahoma	104-109
Minnesota - Utah Jazz	97-121
Denver - Milwaukee	128-125
Golden State - Phoenix	117-107
Portland - Memphis	113-98
Lakers - Sacramento	83-84

Orlandon, ndërsa Detroiti fitoi 108-96 në fushën e Brooklynit, sfidë ku u dallua Jacksoni me 29 pikë.

SHKURT

Salah, njeriu i rekordeve në Premierë Ligë

Me golin e shënuar kundër Crystal Palaces, që i dha fitoren skuadrës së Liverpoolit, Mohamed Salah barazoi dy rekorde në Premierë Ligë. Goli në minutën e 84-t në "Selhurst Park" ishte i 29-i për të në 21 ndeshje të ndryshme të sezonit 2017/18 në Premierë Ligë. Në këtë mënyrë ai barazoi rekordin e vënë nga Cristiano Ronaldo (2007/08) dhe Robin Van Persie (2012/13), të cilët shënuan 29 gola për Manchester Unitedin në harkun e 38 javëve. Salah ka edhe gjashtë ndeshje në dispozicion për ta thyer rekordin e tyre dhe rekordin e Andrew Cole, i cili shënoi 34 gola në sezonin 1993/94, që kishte 40 ndeshje, si golashënuesi më i mirë i të gjitha kohëve në harkun e një sezoni në Premierë Ligë. Ndërkohë, Salah ka barazuar rekordin e Didier Drogba me 29 gola për Chelsea në sezonin 2009/2010, si futbollisti afrikan që ka shënuar më shumë gola në një sezon në kampionatin anglez. Ndeshjet e mbetura të Salah në këtë sezon do të jenë kundër Evertonit, Bournemouthit, West Bromit, Stokes, Chelseas dhe Brightonit.

Shkarkohet Pardew

West Bromwich Albion pas tetë humbjeve radhazi e ka shkarkuar trajnerin Alan Pardew, i cili ishte emëruar trajner i ri para katër muajsh. WBA-ja në javët e mbetura pritet të drejtohet nga trajneri Darren Moore, kurse mbijetesa duket të jetë një mision i vështirë për t'u arritur.

Bayerni vendos ta blejë Jamesin

Bayern Munchen ka vendosur të blejë James Rodriguez për 42 milionë euro. Duke shtuar këtu edhe 13 milionë të tjera, në total Reali fiton 55 milionë euro nga kolumbiani. Jamesi e nisi aventurën mes shumë dyshimeve në "Alianz Arena", por tani është ambientuar dhe ka fituar respektin e të gjithëve.

Aguero në dyshim për ndeshjen ndaj Liverpoolit



Manchester City pritet ta nisë ndeshjen kundër Liverpoolit në Ligën e Kampionëve pa sulmuesin kryesor, Sergio Aguero. Lajmin e ka konfirmuar trajneri Pep Guardiola. "Do të shohim, ende nuk është stërvitur. Shpresoj se do të jetë në gjendje të na ndihmojë ndoshta jo nga fillimi, por nga stoli", ka thënë Guardiola.

Unitedi e shet Martialin për Balen

Manchester Unitedi është i gatshëm që Anthony Martial për të mbledhur para për të blerë Gareth Bale nga Real Madridi, njofton "The Mirror". 22-vjeçari francez ka shënuar 11 gola këtë stinor në të gjitha garat, mirëpo ka dështuar të performojë në mënyrë konstante, prandaj Jose Mourinho e dëshiron uellsianin Bale për edicionin e ardhshëm.

Immobile thyen rekordin e legjendës Chinaglia

Për sulmuesit duhet të flasin numrat dhe ata që i përkasin Ciro Immobiles janë vërtet të denjë për rekorde. Me dy rrjetat kundër Beneventos, bomberit i Lazios ka prekur kuotën e 36 golave sezonalë, duke kaluar edhe një legjendë të klubit lacial si Chinaglia, e duke vendosur primatin e ri në historinë e ekipit. Në një sezon të vetëm, asnjë futbollist nuk kishte arritur të shënonte kaq shumë me fanellën e bardhekaltërve dhe nisur nga statistikat e sulmuesit, ambiciet e Lazios për në Ligën e Kampionëve do të varen pikërisht nga kjo. Immobile ka shënuar 26 gola në Serinë A këtë sezon, 6 në Evropa Ligë, 2 në Superkupën e Italisë dhe dy në Kupë. Ka një kontrast të pashpjegueshëm mes paraqitjes së Immobiles në kombëtaren italiane dhe në atë me Lazion. Me përfaqësuesen, sulmuesi duket i ngathë dhe aspak efikas, ndërsa me klubin kryeqytetas. Për Këpucën e Artë, sulmuesi rivalizon me Icardin dhe Dzekon, si për ironi të fatit, lojtarë që militojnë në skuadrat që kërcënojnë edhe vendin në Ligën e Kampionëve për Lazion.

Autor : GAZMEND MORINA	KËNGËTARI AUSTRALIAN NË FOTO 1 KEITH	RIPOHIM	KËNGËTARJA ANGLEZE TIKARAM	↓	LLOJ VETURE RUSE MOSHË E RE	EPOKA ERE	DY BASHKË- TINGËLLORE	PASURIA E PATUNDSHME QË SILLTE TË ARDHURA (turq.)	365 DITË	ISH SEKRETARI I OKB-SË KOFI (shq.)	NAIM ABAZI	QYTET UNIVERSITAR NË ANGLI		1				
PLAK ME PËRVOJË QË MERRËJ SI GJYQATAR NË NJË ÇËSHITJE	○					KANAPE E GJERË DHE E GJATË SI SHTRAT (shq.)												
KRYEQYTETI I ARABISË SAUDITE	○					DERË E VOGËL E THURUR ME THUPRA (sh.shq.) PIANISTJA LULE												
BIMË E VENDEVE TË NXEHTA	○						PËREMËR VETOR KËNGËTARJA ... ZARI				ZANORE SHJUE ËMBËLSIRE							
AMERICAN FILM INSTITUTE	○			SËMUNDJE E TOKËS, EPILEPSI MBRET ILIR (shq.)					KUNDREJT MBI TEFTA TASHKO									
▶	○				BOTIM QYTET I MADH NË GJERMANI (shq.)							BOLIVIA, MALTA						
AKTORJA SHQIPTARO - AMERIKANE BERISHA	EMËR I VJETËR PËR DUBROVNIKUN BIMË E VENDEVE TË NXEHTA PËR ORENDI							TENESI LLOJ VEPRE MUZIKORE		BEKIM BERISHA "DETROIT"								
ADEM MIKULLOVCI			REOMIR, LITËR; INTENSITET PËSHPËRIT DIKUJT FJALË MAGJIKE			BASHKËTIN. ARTI I VALLEVE ME FIGURA QË LUHEN NË SKENË		HUMBJE NË MJETË; DËMTIM STADIUMI MË I MADH NË BRAZIL				NDËRTESE QË SHËRBENTE SI BUJTINË (sh.shq.)	ANA VISI	MARK ANTONI	INATOSJET	ISH ATLETI AMERIKAN MONTGOMERI		
DY NOCIONE QË KANË NDËRMJET TYRE LIDHJE TË DYANSHME						FUTBOLLISTI MARK VAN (BAYERN MUNICH)						FUTBOLLISTI TURK ALTINTOP TEFIK OSMANI						
KRYEQYTETI JORDANEZ						SKAJI, QOSHJA KASTRIOT TUSHA				KADRI ROSHI	PJESA E EPËRME E DHOMËS SILIC							
BASHKËTIN- GËLLORE		NOTË MUZIKORE KOMPOZITORI RUDI			KËNGËTARJA AMERIKANE NË FOTO 2 KELLY	○	○	○	○	○	○	○	○	"DARDANIA"	ALYSSA MILANO AKTORI YNË PRAPASHTICA			
NJËSI KOHE				BURRË SHTETI (shq.) QË I PËRKET ETIKES								ALBANOLOGIA DURHAM QË PRODDHOET NË SERI				AKTORI YNË MUÇAJ		
NDESH PAPRITUR						SHKOP I BILARDOS VIJOR				LËVIZJA KOMBËTARE	DIKTATOR SOVJETIK PARADA USHTARAKE							
EPOKA ERE	RRIP I LLAMBËS DY BASHKË- TINGËLLORE							BJESHKË LLOJ MINERALI PËR PLLAKA IZOLIMI				VIJA E HAPUR NGA UJËRAT E SHIRAVE PËRËSË I HUNËVE						
BINDJA E FORTË SE DIÇKA ËSHTË E VËRTETË							KRYEQYTETI I NJË SHTETI EVRO-AZIATIK PJESË E BRENDSHME E NJË LOKALI						BAKËR TË FTOHTË I MADH					
SUDANI, TAJVANI			NDËRTESE E POSACME KU SHFAQEN FILMA							MERITA (perkdh.) NJERI I POSHTËR			"TORINO" EMËR FEMRE MYSLIMANE					
						KËNGËTARJA ... KOÇI			MINORITETI SHKRONJA XXXI						SHKRONJA XIX TENISTJA KURNIKOVA			
						QË SHFAQET SI MBETURINË E TRASHËGUAR NGA TIPARET E PARAARDHËS- VE TË LASHTË						KAFSHË E VISEVE TË AMERIKËS JUGORE SECILA NGA PJESËT E NJË NDËRTESE				PERËNDESHA E DASHURISË ROMAKE (mit. romake)		
						KLUB FUTBOLLI FRANCEZ (shqip.)			PLUHUR SHUMË I ËMBËL KRISTALOR KATARI, SUDANI									
						EPOKA ERE	"RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS" TRAJNERI KROAT ... BARIÇ				NOTË MUZIKORE ISH PORTIERI GJERMAN OLIVER ...		VENDI KU LIDHEN ESHTRAT	KORNIZË SHTEG, RRUGË E NGUSHTË				
						OHIO, INDIANA			SKIATORE DY BASHKË- TINGËLLORE							ZANORE TOKIO, NAIROBI		
						QË NUK PLOTËSËT- OHET ME DY (mat.)				"ASHTU QOFTË" (shq. - fet.) AUSTRIA					AUTOTARGA E TIRANËS ZANORE			
					DOLLAPI, RAFTI							SIMBOL I FESË MYSLIMANE, BESIM (shq.)						

SGJIDHJA E FJALËKRITËRIT: L. URTAR, DIVANI, RIADI, TRINAT, BANANË, ATË, O. AFIL, ILET, NËN, ANITA, EITIM, RAGUZA, T. BB, AM, RLI, S. DËM, BINOMI, BOMEL, HAMIT, AMANI, ANA, TAVANI, N. M. KLARKSON, AM. ORA, SHTETARI, EDIT, ZATËT, TAK, STALIN, FITIL, ALPE, BESIMI, ANKARA, REM, ST, KINEMA, RITA, TO, ENI, PAKICA, N. ATAVIK, LAMA, REN, SAKARINA, RTK, LA, RAM, OI, SKITARE, O. TEK, AMINI, TR, ORMANI, IMANI.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA -VLADA-GOVERNMENT

MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Agjencia Pyjore e Kosovës
Agjencia za Šume Kosova
Kosovo Forest Agency

Sektori i Burimeve Njerëzore
Kancelarija osoblja i razvoja ljudskih resursa
Office of Personnel and Human Resources Development

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës NR.03/L-149 dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Miratimit përmes SIMBNJ të pozitës nga MAP me datë 29.03.2018, bënë:

SHPALJEN E KONKURISIT PËR KËTË VENDË PUNE

-I-
Titulli i pozitës: Zyrtar/e Ligjor/e 2
Ref: APK-05/18
Njësia organizative: Drejtorati Koordinues i APK në Ferizaj
Vendi i punës: Ferizaj(1)
Nëpunësi Mbikëqyrës: Drejtorati Ligjor -Drejtori i Drejtorisë Koordinuese në Ferizaj –
Kategoria funksionale: Niveli profesional
Grada e pagës (Koefficienti): Grada 9, koefficienti 7
Lloji i pozitës së punës: E JOKARRIERËS (E përkohshme), deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Kompetente për NC të larguar,

Kohëzgjatja e periudhës provuese: Tre (3) muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Interpretim dhe përcjellje zbatimit e Ligjit për pyjet e Kosovës, aktet nënligjore, udhëzimet administrative në interes të DKR të APK -së.
- Përfaqësimi i DK te APK-së nëpër gjykata kompetente për përfaqësimin e lendeve lidhur me demet e pyjeve, tokave pyjore dhe kontesteve tjera gjyqësore, sipas padive të ushtruar ndaj APK si dhe te APK-së ndaj te tjerëve.
- Përpilimi dhe ushtrimi i propozimeve të përmbartimit të lendeve sipas vendimeve gjyqësore te formës se prerë ne gjykatat kompetente.
- Pranimi, evidentimi dhe ruajtja e vendimeve, aktvendimeve, aktgjykimeve dhe shkresave tjera të kësaj natyre të dërguar nëpër gjykata apo të ardhura prej tyre.
- Hartimi, përpunimi i raporteve te rregullta i fletëparaqitjeve te dëmeve pyjore (muajore dhe periodike-vjetore) për nevoja te APK qendër dhe nevoja te DK te APK.
- Përcjellja e evidencës se zgjidhjes se lëndëve ne gjykata për dëme pyjore dhe dëme tjera në pyje dhe toka pyjore si dhe mbajtjen e shënimeve te dëmtuesve permanent.
- Ne baze te kërkesës se Drejtorisë se Administratës se Përgjithshme -Sektorit Përkates te APK do te përgatis raportet dhe sqarimet e kërkuara nga auditorët e brendshëm dhe te jashtëm ne nivel te Drejtorisë Koordinuese.
- Do te bashkëpunoi ngushtë me zyrtarin përkatës ne APK qendër si dhe sipas nevojës do te i ndihmoj, zyrtarin për mbrojtje te pyjeve dhe shefat e njësive komunale te AP ne interes te menaxhimit te qëndrueshëm te pyjeve.
- Hartimi i kërkesave, ankesave, akteve dhe parashtrësive tjera juridike për zbatimin e procedurave përkatëse ne favor te DK te APK.
- Realizimi dhe kryerja e punëve të tjera sipas urdhrit të Drejtorit te DKR dhe DL-APK.

Shkathësitë kyçe, aftësitë dhe përvoja :

- Minimum dy vite përvojë pune ne profesion
- Aftësi për vendimarrje, planifikim, vendosjen e prioriteteve në punë dhe vetë iniciativë
- Fleksibilitet dhe aftësi për të përballur me situata te reja;
- Njohja e kompjuterit dhe aftësia për të përdorur me efekt Microsoft Office, pajisjet tjera te zyrës,
- Zotimi i një prej gjuhëve zyrtare në të shkruar dhe në të folur në Republikën e Kosovës
- Aftësi për punë ekipore dhe motivim të ekipit,
- Zotësi për punë në mjedis shumetnikë
- Aftësia dhe gatishmëria për bashkëpunim dhe punë në terren.
- Aftësia për evitimin dhe shmangien e situatave konfliktuoze.
- Aftësia dhe gatishmëria për punë nën presion.
- Aftësi për përgatitje të raporteve, shkresave, kërkesave dhe informatave zyrtare.
- Të mos jetë i gjykuar për vepër penale me vendim të formës së prerë si dhe të mos ketë të iniciuar aktakuzë të prokurorishtme hetimore penale,

Nëse kandidati ka punuar apo punon në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës:

- Të ketë vlerësime pozitive të punës në dy (2) vitet e fundit nga Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë
- Të mos jetë në procedurë disiplinore dhe të mos jetë i ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore në tri (3) vitet e fundit.

Kualifikimet arsimore dhe profesionale për këtë pozitë:

- Diplomë universitare -Fakulteti Juridik (konformë Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.16/2016 për Parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe univeritare të fituara jashtë Republikës së Kosovës)

Procedura e Konkurrimit:

Është e hapur edhe për kandidatë jashtë Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës.

Data e shpalljes së konkursit: 03.04.2018

Data e mbylljes së konkursit: 17.04.2018

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit NR.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Vetëm kandidatët që hyjnë në listën e përzgjedhur do të informohen.

Dokumentet duhet të jenë fotokopje përndryshe nuk kthehen.

Procedura e Aplikimit: Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Sektorin e Burimeve Njerëzore zyra nr.2 në Agjencinë Pyjore të Kosovës, Rr. Zenel Salihu 1/A Prishtinë (prapa Muzeut të Kosovës).

Për informacione tjera shtesë kontaktoni në telefonin nr. 038-200-38-482 çdo ditë pune prej orës 8⁰⁰ deri 16⁰⁰.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA -VLADA-GOVERNMENT

MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Agjencia Pyjore e Kosovës
Agjencia za Šume Kosova
Kosovo Forest Agency

Sektori i Burimeve Njerëzore
Sektor Ljudskih Resursa
Office of Personnel and Human Resources Development

Na osnovu Zakona za Civilnu Službu Republike Kosova Br.03/L-149, Pravilnika Br.02/2010 za Procedure Rekrutovanja u Civilnoj Službi Republike Kosova i Usvajanja izdato preko ISMJALJR,sa pozicija od MJA, dana 29.03.2018, Raspisuje:

KONKURS ZA SLEDEĆA RADNA MESTA

-I-
Naziv pozicije: Pravni Službenik
Ref: AŠK -05/18
Organizaciona Jedinica: Koordinaciona Direkcija AŠK u Ferizaj
Radno mesto: Ferizaj (1)
Nadzorni Službenik: Direktor Pravne – Direktor Koordinacione Direkcije AŠK u Ferizaj
Funksionalna kategorija: Profesionalni nivo
Grada plate (Koefficient): Grada 9, koefficient 7
Vrsta radne pozicije: NE KARIJERNE (neodredeno) do prvosnažne odluke Nadležog Suda za udaljenog CS

Probni Vremenski period: tri (3) meseci

Zadaci i odgovornosti:

- Vršiti tumačenje i vrši nadzor sprovođenja Zakona za Šume Kosova, podzakonskih akata, Administrativna Uputstva u interesu RKD – AŠK –a.
- Zastupanje RKD- a - AŠK –a, u nadležnim sudovima i zastupanje sudskih predmeta u vezi šumskih šteta, šumskog zemljišta i drugih sudskih parnica, prema podnošenim prijava protiv AŠK- a i obrnuto.
- Izrađuje i podnosi predloge za izvršenje predmeta po pravosnažnim sudskim odlukama donešenih od strane nadležnih sudova.
- Primanje, evidentiranje i čuvanje odluka, rešenja, presuda i drugih dopisa ove prirode, podnesetih po sudovima i primljene od strane raznih sudova.
- Izrada i obrada redovnih izveštaja prijava, šumskih šteta (mesečnih i periodičnih – godišnjih) za potrebe AŠK – centar i potreba RKD – AŠK –a.
- Praćenje evidencije rešenih predmeta po sudovima, za šumske štete i drugih šteta šuma i šumskih zemljišta ka i održavanje podataka stalnih šetnika.
- Na osnovu zahteva Direkcije Opšte Administracije – dotičnog Sektora AŠK- a, pripremiće izveštaje i objašnjenja zatražene od Unutrašnjih i Stranih Auditora na nivou RKD- a.
- Saradivaće usko sa odredenim Službenikom AŠK- a – centar kao i po potrebi pomagat će Službenika za čuvanje šuma i Šefova Opštinskih Autoritete, od interesa stabilnog menađiranja šuma.
- Izrada zahteva, žalbi, akata i drugih pravnih dopisa za sprovođenje dotičnih procedura U interesu RKD - AŠK- a.
- Realizacija i izvršenje drugih poslova po naredbu Direktor RKD- a i Direktora PD - AŠK- a.

Ključne veštine, sposobnosti i iskustvo :

- Minimalno dva(2) godina radno iskustvo u profesiji,
- sposobnost za sprovođenje odluka,planova, ispostavljanje prioriteta na rad i samoinicijativu,
- Fleksibilnost i sposobnost da se suoči sa novim situacijama,
- Poznavanje kompjutera i sposobnost za efektanu upotrebu Microsoft Office, druga kancelarijska oprema,
- sposobnost upoznavanja jednog od službenog jezika pismeno i usmeno na Republici Kosova,
- Sposobnost za timski rad i motivisanje tima,
- sposobnost i spremnost za saradnju i rad na terenu,
- sposobnost za rad u multietničkim sredinama,
- sposobnost za izbegavanje i otklanjanje konfliktnih situacija,
- sposobnost za pripremu izveštaje ,dopisa, zahteva i službenih informacija,
- da nije kažnjen za krivično delo sa pravosnažnom odlukom i da nije pokrenuta nikakva krivična istraga.

Ako su kandidati radili ili rade u Civilnoj Službi Republike Kosova:

- Dve (2) zadnje godine da ima pozitivne ocene od svog neposrednog rukovodioca,
- Da nije u disciplinskoj proceduri i da nije kažnjen sa disciplinskim merama u tri (3) zadnje godine.

Obrazovna i stručna kvalifikacija za ovu poziciju:

-Univerzitetska diploma-Pravni Fakultet (shodno Administrativnog Uputstva (MPNT) Br16/2016 za načela i procedura poznavanja diploma, činova i kvalifikacija visokih škola, visokih profesionalnih škola i univerzitnih, dobijenih van Republike Kosova.)

Procedura konkurisanja:

Jeste otvorena i za kandidate van Civilne Službe Kosva.

Datum proglašenja konkursa,03.04.2018

Datum zključenja konkursa, 17.04.2018


Civilna Kosovka Služba pruža jednake mogućnosti zaposlenja svim državljanima Kosova i prima aplikacije svih lica muškog i ženskog pola iz svih zajednica u Kosovu.

Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju prave da budu predstavljeni proporcionalno na organima Javne Službe na lokalnim i centralnom nivou ,kao što je nažnačeno i čl.11, paragraf 3 Zakona Br/03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova.

Nekompletirane dokumentacije se neće uzeti u obzir. Biće informisani samo kandidati koji uđu u uži spisak kandidata.Dokumenti treba biti fotokopije jer se neće vratiti.

Postupak konkurisanja: Obrasci za konkurisanje se mogu dobiti i dostaviti Kancelarija osoblja i razvoja ljudskih resursa, kancelarija br.2 pri Agenciji za Šume Kosova, Ul. Zenel Salihu nr. 1/A Prishtina (iza Muzeja Kosova).


Za dodatne informacije kontaktirajte na telefon br. 038-200-38-482 svakog radnog dana od 8⁰⁰ do 16⁰⁰ časova.



Revistën për kulturë, gjuhë, media, "Akademia", mund ta gjeni në redaksinë e gazetës "Epoka e re", në Sheshin "Edit Durham", 100 metra larg "Grand Hotel"-it. Për informata të tjera mund të thërrisni në këtë numër të telefonit: +377 44 127 434.



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



Zyra e Kryetarit
Datë: 03.04.2018
Junik

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nën titullin 11, paragrafi 1, nën titullin 18 paragrafi 1 dhe 3, dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit mbi Shërbimin Civil, nën titullin 3 paragrafi 1 dhe 2. Komuna e Junikut Shpall këtu:

K O N K U R S

Institucioni:	Komuna e Junikut
Drejtoria:	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirënjehje Sociale
Titulli i vendit të punës:	Asistent Administrativ 3 (1 nëpunës)
Kategoria funksionale/Grada:	Koeficienti- 6
Numri i referencës:	RN00002973
Lloji i pozitës:	I karrierës

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Siguron mbështetje të përgjithshme administrative dhe teknike përfshirë postën zyrtare, telefonatat, skanimin, faksimin dhe kopjimin e dokumenteve, plotësimin e raporteve të shpenzimeve, si dhe hartimin e dokumenteve për takime të ndryshme 25%
2. Përgatit dhe modifikon dokumentet duke përfshirë korrespondencën, raportet, memorandumet dhe e-mailat për mbikëqyrësin 20%
3. Pranon dhe shpërndan korrespondencën për mbikëqyrësin dhe kujdeset për mirënjehjen e saj 15%
4. Runn dhe mirëmban sistemin elektronik dhe kopjet fizike të dokumenteve dhe dosjeve të zyrës së mbikëqyrësit 15%
5. Menaxhon kalendarin e takimeve dhe ngjarjeve tjera për mbikëqyrësin si dhe ndihmon në zgjidhjen e ndonjë problemi administrativ dhe teknik 15%
6. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi 5%

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejte aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, kanë përgatitjen e nevojshme shkollore dhe aftësi fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatet e interesuar.

Shkollimi i kërkuar: Arsimim i mesëm.

Aftësi / përvojë dhetribute tjera që kërkojnë: Të ketë trajnim përkatës dhe së paku tre (3) vite përvojë pune në fushën përkatëse teknike ose administrative.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në ndërtesën e Komunës pranë: **Zyrës Pritëse**. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit nga data: **03-04-2018 deri 17-04-2018**.

Aplikacionit i bashkëngjitet kopja e dokumentacionit mbi kualifikimin: Ekstraktin e lindjes, përvojën e punës, Certifikata të trajnimeve nëse ka, Letërjofftimi i Republikës së Kosovës, Certifikata Shëndetësore dhe dokumentacione tjera për këtë pozitë. Kandidatet të cilët përzgjidhen në listën e ngushte për intervistë njoftohen me shkrim ose në telefon në afat ligjor, kandidatet janë të obliguar që të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimin, trajnimet dhe të gjitha ato dokumente të cilat janë dorëzuar në aplikacion, dhe të cilat duhet të verifikohen nga Komisioni Intervistues.

"Shërbimi Civil i Kosovës u shërben të gjithë banorëve të Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga femrat dhe meshkujt e të gjitha komuniteteve të Kosovës".

Udhëheqësja e personelit
Venera Shala



Lumë's Details

Estetik & Depilim



044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumescdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift në Fushë Kosovë. Banesa duhet të ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë të jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do loj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira në Prishtinë, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet të ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truallit frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truallit frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxejje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektesë si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkohet kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë, në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info: 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel: 044/171-328.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

Urgjentisht kërkohet një shtëpi me qira në Prishtinë. Shtëpia duhet të jetë e veçantë, duhet të ketë 5 ose 6 dhoma gjumi. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel 049-472-770

► URGJENTISHT KËRKOJ BANESË PËR ZYRE ME QIRA
Në qendër të Prishtinës, kërkohet banesë me qira, për zyrë. Hapësira 80-100m2.
Kati i -I- deri në katin -III-.
Tel: **044741155**

Lajmërohen bashkëpronarët e ngastrës kadastrale P-70202016-0440 bk-O, se bashkëpronari Arif Gërxhaliu ka shprehur dëshirën që të ashë një pjesë të pronës së vet. Andaj njoftohen bashkëpronarët e kësaj parcele kadastrale që nëse janë të interesuar për blerjen e kësaj parcele-pjesën e pronës të lajmërohen te bashkëpronari Arif Gërxhaliu.

LËSHOJ LOKALIN ME QIRA.

Lokali gjendet në rrugën "Isa Kastrioti" në Matican të Prishtinës dhe ka një hapësirë prej 400 m2. Lokali është i gatshëm dhe shumë funksional. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-509-077.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkohet 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

